



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

VLERËSIM

*Procesi i Menaxhimit të Rastit
dhe Mekanizmat Lokal të
Referimit me fokus në
Shëndetësi dhe Masat e
mbrojtjes në kontekstin e
COVID-19*

Tiranë, 2021

TABELA E LËNDËS

SHKURTIME	3
LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE & ANEKSEVE	4
I. HYRJE	5
II. METODOLOGJIA	6
III. GJETJET DHE VLERËSIMET	8
MJAFTUESHMËRIA E UDHËZIMEVE LIGJORE	8
STRUKTURA DHE BURIMET NJERËZORE	8
MASAT E MARRA NGA BASHKITË DHE INSTITUCIONET SHËNDETSORE DHE TË ARSIMIT.....	9
MENAXHIMI I RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË PËR MBROJTJE.....	9
OFRIMI I SHËRBIMEVE.....	10
KOORDINIMI NDËRSEKTORIAL, NDARJA E PËRGJEGJËSIVE DHE SIGURIA.....	11
IV. KONTEKSTI LIGJOR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, PËRFSHIRË SITUATËN E COVID-19	122
V. PROCESI EKZISTUES I MENAXHIMIT TË RASTIT DHE MEKANIZMAT LOKAL TË REFERIMIT TË SITUATËN E PANDEMISË COVID-19	244
MJAFTUESHMËRIA E UDHËZIMEVE LIGJORE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19.....	255
STRUKTURAT	266
IDENTIFIKIMI/RAPORTIMI DHE VLERËSIMI I RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË PËR MBROJTJE.....	300
PLANIFIKIMI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE	333
SHËRBIMET SHËNDETSORE DHE ARSIMORE.....	400
FONDET.....	433
REKOMANDIME	444
REFERENCA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.0
ANEKSE	61

Ky vlerësim është prodhuar në kuadër të projektit "Mbështetje emergjente dhe rimëkëmbje për fëmijët dhe familjet e prekura nga situata pandemike COVID-19 në Shqipëri" financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Misioni Terre des hommes në Shqipëri. Përmbajtja e këtij raporti, botim ose pikëpamjet e autorit nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.



SHKURTIME

- MSHMS – Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale
- ASHDMF – Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
- GTN – Grup Teknik Ndërsektorial
- KDF – Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
- VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave
- MF – Mbrojtja e Fëmijëve
- MR – Menaxhimi i Rastit
- IK – Informatorë kyc
- PMP – Pajisje mbrojtëse personale
- NJMF – Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
- NJVNR – Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
- DRSHSSH – Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
- ZVA – Zyra Vendore Arsimore
- NJVKSH – Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetsor
- QKM – Qendër Komunitare Multifunksionale
- QKSHM – Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor
- PAK – Personat me Aftësi të Kufizuar
- PMF – Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve
- TDH – Terre des hommes
- NISMA – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
- ALO 116 – Linja e ndihmës për fëmijë ALO 116



LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE & ANEKSEVE

Tabela

- Tabela 1. Profesiontët e përfshirë në intervista sipas pozicionit
- Tabela 2. Mekanizmat dhe strukturat përgjegjëse për MF në RSH
- Tabela 3. Shpërndarja e PMF-ve në bashkitë përkatëse
- Tabela 4. Prioritarizimi i nevojave sipas fëmijëve/prindërve

Grafikë

- Grafiku 1. Nevojat e fëmijëve/prindërve në kushtet e emergjencës
- Grafiku 2. Shërbimet që fëmijët dhe familjet kanë marrë në kushtet e emergjencës

Anekse

- Aneks 1. Intervistë për PMF
- Aneks 2. Intervistë për punonjësit e Shëndetësisë, QKM, OJF
- Aneks 3. Intervistë për punonjësit e shërbimit psiko-social/ drejtues/ mësues të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme.
- Aneks 4. Fokus Grupe me fëmijët dhe prindërit



I. HYRJE

COVID-19 ndryshoi shpejt kontekstin në të cilin jetonin fëmijët. Në një situatë kur shkollat dhe institucionet të kujdesit për fëmijë u mbyllën (vecanërisht periudha mars-shtator 2020) dhe gjendja e mbingarkuar e jetesës ku familjet janë të mbyllura, prindërit dhe kujestarët të stresuar për shumë arsye (humbja e vendit të punës) fëmijët janë në rrezik të rritur të abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit.

Këta skenarë të shfaqur, krijuan nevoja dhe situata që përcaktuan kërkesën për metoda më të sigurta të ofrimit të shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Si i tillë, Menaxhimi i Rastit për mbrojtjen e fëmijëve është pjesë e shërbimeve thelbësore që nuk mund të ndalet papritmas, por që kërkon përshtatje me emergjencën, me situatën e re duke mbajtur në konsideratë parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Gjatë emergjencës u konstatua se përcaktimi i metodologjive të ofrimit të shërbimeve, qoftë menaxhimi i rastit ballë për ballë “apo në “distancë”, shpesh varen nga mjedisi i fëmijës, i cili merr parasysh nivelin e rrezikut Covid-19 në familje dhe në zonë dhe ashpërsinë e secilit rast.

Në këtë kontekst, punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, profesionistët e tjerë të shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të arsimit, në kushtet e një sacrifice të madhe profesionale dhe njerëzore, u përballën dhe vazhdojnë të përballen (edhe pse kohët e fundit për hir të së vërtetës në një situatë pak më lehtësuese, por jo normale) me vështirësi dhe sfida, për t'u përshtatur me këtë situatë të re, për të ruajtur standardet e performancës dhe eficiencën si edhe për të zgjidhur çështje etike që lindin nga konteksti i ri Covid-19.

Vlerësimi i procesit të Menaxhimit të Rastit dhe mekanizmat lokalë të referimit me një fokus të veçantë në shëndetësi dhe masat e mbrojtjes në situatën e pandemisë Covid-19, bazohet në kontekstin ekzistues të reagimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të tilla, si: shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore në disa bashki, si: Durrës, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë, të përfshira në kuadrin e projektit "Mbështetje emergjente dhe shërbim për fëmijët e prekshëm dhe familjet e prekura nga Covid-19, situata pandemike në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Europian, implementuar nga Terres des hommes.

Vlerësimi synon që përmes rishikimit të procesit të Menaxhimit të Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, referuar bazës ligjore, reagimit të shërbimeve në kontekstin e emergjencës, masave të marra nga qeveria lokale në bashkitë e synuara të projektit për t'iu përgjigjur fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të sigurojë rekomandime për përshtatjen e ndërhyrjeve të menaxhimit të rastit për fëmijët në rrezik dhe modelimin e një mekanizmi lokal efektiv të referimit ndërmjet shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe shërbimeve mbrojtëse në situatën e pandemisë Covid-19, si një parapërgatitje për situatat e emergjencës në përgjithësi.



II. METODOLOGJIA

Ky vlerësim bazohet në kontekstin ekzistues të reagimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të tilla, si shërbimet sociale (MR), shëndetësore, arsimore në disa bashki, si: Durrës, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë, të përfshira në kuadrin e projektit "Mbështetje emergjente dhe shërbim për fëmijët e prekshëm dhe familjet e prekura nga Covid-19, situata pandemike në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Europian, implementuar nga Terres des hommes, i cili ka si qëllim:

- Të kuptohet roli i rëndësishëm i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik në situata emergjente, si pandemia dhe rëndësia e vazhdimësisë së MR duke adaptuar veprimet për secilin nga hapat e menaxhimit të rastit (MR), në mënyrë që të vazhdojmë të mbështesim më të prekshmit dhe për t'iu përgjigjur rasteve të reja të krijuara gjatë emergjences.
- Modelimin e një mekanizmi efektiv referimi lokal midis shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve mbrojtëse, "se si të mbrohen më mirë fëmijët në rrezik gjatë situatave emergjente, dokument i cili duhet të sqarojë rolin e aktorëve kryesorë gjatë MR në situatat e emergjencës dhe rëndësinë e bashkëpunimit dhe të koordinimit midis tyre.
- Të sigurojë rekomandime për përshtatjen e ndërhyrjeve të menaxhimit të rastit për fëmijët në rrezik në situatat e pandemisë Covid-19, si një parapërgatitje për situatat e emergjencës në përgjithësi.

Është e rëndësishme që agjencitë e menaxhimit të rasteve dhe ofrimit të shërbimeve të planifikojnë paraprakisht potencialin e aksesit për fëmijët dhe familjet në kushte emergjence.

Metodat

Për arritjen e objektivave të sipërlistuar, studimi kombinoi disa metoda si më poshtë:

1. Rishikimi i literaturës dhe kuadrin ligjor me synim evidentimin e udhëzimeve të dala për Menaxhimin e Rastit (MR) dhe ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore, të arsimit etj, në kushtet e pandemisë, të strukturave dhe institucioneve të ngarkuara me detyra dhe përgjegjësi në nivel vendor, por jo vetëm.

2. Ky është një vlerësim cilësor dhe për mbledhjen e informacionit u përdorën instrumente cilësorë, si FG dhe Intervista me punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve (MF) në bashkitë e targetuara si: punonjës për mbrojtjen e fëmijëve (PMF), drejtues të shërbimit social në bashki (shih Aneksi1), mjekë familjeje, përfaqësues të njësive vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Zyrës Vendore Arsimore, nga Shërbimi psiko-social në shkollë, mësues (Aneksi 3), punonjës socialë pranë Qendrave Komunitare Multifunkionale (QKM) (Aneksi 2) në bashkitë përkatëse, mbi funksionimin e mekanizmit të Menaxhimit të Rasteve (MR) dhe funksionimin e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN).



Pyetjet e parashikuara në këto intervista synojnë të hedhin dritë mbi:

- Masat e marra dhe gatishmëria nga qeveria lokale në bashkitë e synuara të projektit për t'iu përgjigjur fëmijëve në nevojë për mbrojtje në situatën e emergjencës Covid-19 ”;
- Shërbimet themelore për fëmijët në nevojë për mbrojtje, siç janë ushqimi,shëndeti dhe arsimi, aksesimi në mësimin on-line, mbështetja psikologjike;
- Mënyrat e identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga strukturat përgjegjëse dhe çdo shërbim tjetër i mbrojtjes së fëmijëve gjatë Covid-19,specifikisht në periudhën e izolimit;
- Bashkëpunimin midis institucioneve, veçanërisht (punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, profesionistë të shëndetit, psikologë shkollorë);
- Zbatimin e protokolleve shëndetësore nga drejtoritë shëndetësore dhe profesionistët;
- Masat e sigurisë të marra nga NJMF-të duke përshtatur aktivitetet e tyre për rastet në nevojë dhe në të njëjtën kohë në përputhje me protokollet e rrepta Covid-19.
- Disponueshmëria e shërbimeve komunitare (organizata qeveritare dhe të shoqërisë civile,grupet komunitare) për të mbrojtur fëmijët gjatë Covid-19;
- Niveli i bashkëpunimit të PMF-ve me aktorët e tjerë të GTN-së, përmbushja e përgjegjësisë, koordinimi ndërsektorial, riorganizimi, siguria e punonjësve dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve në kushtet e Covid-19.

3. Realizimi i fokus-grupeve me fëmijë dhe prindër përfitues të shërbimeve në kushtet e pandemisë Covid-19 (Aneksi 4) me qëllim evidentimin e masave të marra nga strukturat përgjegjëse, mënyrën dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve, përfshirjen e familjarëve në proces, perceptimin e familjarëve mbi vlefshmërinë e procesit të MR në kontekstin e Covid-19.

Popullata dhe kampioni i përfshirë në studim

Popullata e studimit përfshiu punonjës të angazhuar në strukturat vendore të sistemit të MF në bashkitë e përfshira në vlerësim, si: PMF, mjekë familjeje, përfaqësues të njësive vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nga Zyra Vendore Arsimore, nga shërbimi psiko-social në shkollë, mësues, punonjës socialë pranë Qendrave Komunitare Multifunkionale (QKM) në bashkitë përkatëse. Për një kuptueshmëri më të mirë të situatës, u realizuan intervista të thelluara me informatorë kyç (IK), të angazhuar në sistemin e MF në pozicione menaxheriale apo drejtuese, si: përgjegjës sektori, koordinatori i shërbimit psiko-social pranë ZVA, drejtues të shërbimit social në bashki, përfaqësues të ASHMDF.

- Në përfundim të procesit u realizuan 53 intervista sipas tabelës së mëposhtme:

Pozicioni	Bashkia	Shëndetësia	Arsimi	Dr. SHSSHR	ASHMDF	QKM	OJF
PMF	13						



IK	5		2		1		
Mësues			6				
Psikologë shkollorë			4				
Mjekë familjeje		2					
Punonjës socialë		2 NJVKSH		2		5	6
Infermierë		2					

Tabela 1. Profesionistët e përfshirë në studim sipas pozicionit

- Dy fokus-grupe me 30 fëmijë dhe 30 prindër (Aneksi 4).

Përzgjedhja e pjesëmarrësve të fokus-grupeve me fëmijët dhe prindërit u mbështet në termat e referencës së vlerësimit që lidhet me fëmijë dhe prindër në nevojë, të cilët kanë marrë shërbime gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. U realizuan dy fokus-grupe, me nga 15 fëmijë të moshës 10-18 vjeç në nevojë për mbrojtje që marrin shërbime pranë qendrave komunitare. Për secilin fëmijë pjesëmarrës në *Fokus-Grup për fëmijë*, u ftuan të marrin pjesë nga *Fokus-Grup për Prindërit* edhe prindi apo kujdestari i tij / saj, rrjedhimisht edhe dy Fokus-Grupe të prindërve patën afërsisht 30 persona (Aneksi 4).

III. GJETJET E VLERËSIMIT

➤ Mjaftueshmëria e udhëzimeve ligjore

Udhëzimi nr 253, datë 10.04.2020 “Për menaxhimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19 edhe pse ishte një orientim i mirë për PMF-të në atë situatë të paqartë, nuk u shoqërua me një protokoll pune konkret, ku të parashikoheshin më shumë situata dhe sugjerime për adaptimet konkrete të MR / për PMF-të dhe aktorët e tjerë të përfshirë në procesin e Menaxhimit të Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

➤ Struktura dhe burimet njerëzore

Në një situatë emergjence si Covid-19, mungesa e strukturave të NJVNR-së dhe burimeve njerëzore të tyre përfshirë PMF-të parashikuar tashmë në ligjin 121 për “Shërbimet shoqërore”, ka sjellë vështirësi në procesin e menaxhimit të rastit dhe ofrimit të shërbimeve sipas nevojave të rastit.

Mungesa e punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve në nivelin e Njësive Administrative ka bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve ligjore për adresimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në këtë nivel. PMF-të u angazhuan drejtpërdrejt në shpërndarjen e ndihmave emergjente për familjet vulnerabël në situatën e emergjencës gjë që solli:



- ✓ Sfumim të funksionit dhe përgjegjësisë kryesore të PMF-së lidhur me adresimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- ✓ Ezaurimin e tyre deri në “Burn-out”;
- ✓ Shkëputjen nga ndjekja e rasteve në proces menaxhimi dhe mosgjurmimin e rasteve të reja. Këtu bëjnë përjarshtim trajtimi i rasteve emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilat duket se kanë qenë prioritet ndër detyrat funksionale të PMF-së, atë të Menaxhimit të Rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

➤ Masat e marra nga bashkitë dhe institucionet shëndetësore dhe të arsimit

- ✓ Në të gjitha bashkitë në fokus të këtij vlerësimi janë vënë në dispozicion linja telefonike apo shërbimi on-line në ndihmë të individëve në nevojë, por pa i specifikuar si linja të ndihmës për fëmijë, për këshillim psikologjik apo thjesht linja të raportimit të nevojave të qytetarëve;
- ✓ Bashkitë kanë ngritur grupet e emergjencës dhe të gadishmërisë, pjesë e të cilave janë dhe PMF-të, punonjësit socialë të QKM-ve apo vullnetarë;
- ✓ Për t’u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, është vënë në dispozicion një fond shtesë nga bashkitë dhe është koordinuar me shoqatat apo donatorë të ndryshëm. Në këtë fond shtesë nuk ka një specifikim të veçantë për fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- ✓ Institucionet shëndetësore si: qendrat shëndetësore të lagjeve, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor kanë vënë në dispozicion linjat e ndihmës për të orientuar qytetarët por nuk kanë dijeni për udhëzimin 253 për “Menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, ku janë të përfshirë ndër aktorët kryesorë përgjegjës.
- ✓ Identifikimi dhe referimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga qendrat shëndetësore lë për të dëshiruar, gjë që vë në diskutim përgjegjësitë e tyre institucionale;
- ✓ Strukturat arsimore kanë marrë masat e duhura lidhur me mbarëvajtjen e mësimin on-line dhe adaptimin e procesit mësimor me turne për nxënësit dhe mësuesit por një pjesë e mirë e nxënësve nuk kanë pasur mundësi të ndjekin mësimin on-line për arsye të ndryshme;
- ✓ Mësuesit shpesh janë mjaftuar me referimin e nxënësve në nevojë te psikologu i shkollës.

➤ Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

- ✓ Disa mekanizma të referimit dhe raportimit për fëmijët në nevojë për mbrojtje janë prishur duke sjellë numër të ulët të rasteve të identifikuara në një kontekst ku përlligjet rritja e dhunës, abuzimit ndaj fëmijëve si pasojë e efekteve të pandemisë si: izolimi, mbyllja e mjaft institucioneve dhe shërbimeve për fëmijë, mungesa e mjeteve të komunikimit(internet,telefon), distancë e largët nga shërbimet, angazhimin e PMF-ve me përgjegjësi të tjera, etj.



- ✓ Procesi i vlerësimit të rastit në situatën Covid-19 duket se i ka orientuar PMF-të drejt prioritarizimit të rasteve sipas nivelit të rrezikut duke u dhënë përparësi rasteve me rrezik të lartë dhe të menjëhershëm.
- ✓ Në trajtimin e rasteve me rrezik të menjëhershëm, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve gjatë pandemisë ka qenë në ushtrimin e përgjegjësisë kryesore të tij, ajo e marrjes në mbrojtje të fëmijës dhe adresimi i nevojave të tij. Rastet e tjera për hir të kontekstit të emergjencës janë trajtuar si gjithë rastet në nevojë duke ofruar shërbime bazike dhe jo të personalizuar sipas nevojës së fëmijës, jo me në fokus fëmijën.
- ✓ Nisur nga konteksti i emergjencës mund të themi që PMF-të kanë bërë përpjekjet maksimale për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve dhe familjeve në nevojë, por është sfumuar përgjegjësia kryesore e tyre ajo e adresimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ku përjashtim bëjnë rastet me rrezik të lartë/të menjëhershëm.

➤ Ofrimi i shërbimeve

- ✓ Ka munguar vlerësimi i nevojave të fëmijëve dhe familjeve për shërbime, veçanërisht në nivel njësie administrative, e cila do të mundësonte:
 - Shërbime me në fokus fëmijën dhe të orientuara drejt nevojave reale të fëmijëve dhe familjeve;
 - Parandalon mbivendosjen e shërbimeve për të njëjtën familje;
 - Ofrimin e shërbimeve për më të prekshmit dhe jo për familjet që nuk kanë pasur nevojë.
- ✓ Ofrimi i shërbimeve është fokusuar dhe mjaftuar në mbështetjen me pako ushqimore, veshje, pako higjieno-sanitare (të konsideruarit të këtyre mjeteve monetare si shërbime vlen për t'u diskutuar), pjesërisht këshillim psiko-social dhe ndihmë juridike ndërkohë që nevojat kanë qenë përtej këtyre;
- ✓ Shërbimet për fëmijët kanë "vuajtur" gjatë pandemisë, janë përballur me mungesa financiare dhe nuk kanë qenë tërësisht të përgatitura për të përballuar sfidat lidhur me pandeminë. Shërbimet e emergjencës kanë qenë shumë të pakta;
- ✓ Nga vlerësimi, përveç suportit ekonomik ka dalë domosdoshmëri ofrimi i shërbimeve të tjera, si: suporti psikologjik ndaj fëmijëve dhe prindërve, informimi mbi rrezikun e infektimit, masat mbrojtëse, orientimi në shërbimet për të cilat ata kanë nevojë, aksesimi në mësim on-line, argëtimi i fëmijëve, mundësi për të adresuar shqetësimet dhe nevojat e fëmijëve dhe prindërve, të cilat janë ofruar në masë të papërfillshme;
- ✓ Lidhur me aksesin në mësimin on-line nuk kanë përfituar në të njëjtën mënyrë të gjithë fëmijët gjatë pandemisë gjë që paraqet sfida të reja lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve pasi jo të gjithë fëmijët kanë qasje të barabartë në teknologjinë digjitale;



- ✓ Rreziqet e dhunës on-line por jo vetëm, janë rritur gjatë pandemisë, ndërsa shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve si dhe mekanizmat e raportimit dhe identifikimit janë përballur me vështirësi për të vazhduar punën;
- ✓ Shërbimet on-line apo në distancë treguan se duhet të jenë të synuara për një grup të veçantë të popullatës, si në rastin e linjave të ndihmës për fëmijët ose linjave të ndihmës për dhunën në familje, veçanërisht në situatë karantinimi gjatë emergjencës;
- ✓ Pjesëmarrja e fëmijëve në jetën shoqërore, aktivitetet rekreative por edhe në vendimmarrjen që lidhet me Covid-19 ka qenë e kufizuar ashtu si edhe qasja e tyre në informacion;
- ✓ Shërbimet më së shumti gjatë emergjencës janë dhënë në formën e ndërhyrjeve të atypëratyshme (ad hoc) dhe jo në atë të shërbimeve sistematike që do të thotë se ato nuk janë të planifikuara dhe të integruara.

➤ Koordinimi ndërsektorial, ndarja e përgjegjësive dhe siguria

- ✓ Koordinimi ndërsektorial rezulton se ka qenë i copëzuar, ka pasur një lloj organizimi brenda sektorëve, strukturave, institucioneve përkatëse por ka munguar një koordinim i përbashkët i këtyre strukturave, agjencive apo ofruesve të shërbimeve që do të sillte lehtësim të sistemit, koordinim veprimesh, shërbime më cilësore dhe në kohën e duhur;
- ✓ Evidentohet mungesë e burimeve njerëzore duke bërë që punonjës si PMF-të të përfshihen më shumë në shpërndarjen e pakove ushqimore, sesa të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre atë të menaxhimit të rasteve;
- ✓ Koordinim jo i mirë në ofrimin e mundësive për të gjithë punonjësit specifikisht PMF-ve, për të rritur kapacitetet e tyre mbi të punuarit në kushtet e emergjencës. Rezulton një disbalancë në trajnimin e punonjësve në këtë drejtim, disa prej tyre janë mbingopur me trajnime ndërkohë që mjaft të tjerë nuk kanë qenë pjesë e asnjë trajnimit;
- ✓ Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë të gjithë punonjësit socialë në ofrimin e shërbimeve kanë hasur shumë sfida të cilat lidhen me frikën nga rreziku i shtuar i kontaktit me virusin, ngarkesës në rritje të punës, gjendjes së ngarkuar emocionale, mjeteve jo të mjaftueshme mbrojtëse dhe logjistike, mungesës së motivimit dhe supervizimit profesional dhe nevojën për të përshtatur praktikën dhe procedurat e MR në një kontekst të ri emergjence dhe në një afat të shkurtër kohor;
- ✓ Çështjet e mbrojtjes së fëmijëve duket se nuk kanë marrë vëmendjen e duhur për sa kohë kjo nuk është reflektuar në marrjen e plotë të masave nga disa institucione apo ofrues shërbimesh, të parashikuara në udhëzime për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve.



IV. KONTEKSTI LIGJOR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, PËRFSHIRË SITUATËN E COVID-19

- *Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”*¹

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” lidhet organikisht me ofrimin e shërbimeve në qendrat komunitare multifunktionale, me bashkëpunimin e tyre me NJVNR-të dhe PMF-të dhe OJF-të që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe fuqizimit të familjes. Objekti i ligjit është të përcaktojë të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Në kreun 5, ku përshkruhen parimet e ligjit në lidhje me të drejtat e fëmijës, ndër parimet e tjera është dhe “decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuara me ligj”.

Ligji përshkruan në mënyrë të detajuar të drejtat e fëmijës si dhe përgjegjësitë e autoriteteve të ndryshme për përbushjen e këtyre të drejtave në Kreun 2, nenet 7 deri në 22. Në nenin 22 paraqitet e drejta e fëmijës për të marrë shërbimin e kujdesit shoqëror.

Në Kreun III të këtij ligji përshkruhen mekanizmat institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në Kreun IV përcakton masat për mbrojtjen e fëmijës, në Kreun V përcaktohet mbrojtjen e posaçme, ndërsa Kreu VI detyrimin për raportim. Në veçanti, brenda Kreut II, Nenet 46-51 përcaktojnë detyrimet e bashkisë dhe PMF në bashki/njësi administrative lidhur me mbrojtjen e fëmijës. Masat e parashikuara në këtë ligj janë relevante për PMF–në dhe aktorët e tjerë, pjesë e grupit teknik ndërsektorial ku mund të jenë dhe QKM–të. Për shembull, në këtë ligj parashikohen masa për mbështetjen e fëmijëve që janë në mbrojtje, por edhe për aftësimin prindëror të prindërve të këtyre fëmijëve (Neni 61).

- *VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.*²

Ky është një vendim shumë i rëndësishëm për të gjitha rastet e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Si vendim parashikon rolin e PMF-së dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për identifikimin, raportimin, vlerësimin fillestar, vlerësimin e plotë, hartimin e planit individual të mbrojtjes, zbatimin, ndjekjen dhe monitorimin e këtij plani si dhe mbylljen e rastit.

¹<http://fëmijët.gov.al/ep-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18-2017-%E2%80%9CP%C3%8BR-T%C3%8B-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-F%C3%8BMJ%C3%8BS%E2%80%9D.pdf>

² <http://fëmijët.gov.al/ep-content/uploads/2019/01/VKM-nr.-578-date-3.10.2018.pdf>



Kreu II specifikon procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, sipas hapave të menaxhimit të rastit. Kreu III specifikon zbatimin e masave të mbrojtjes. Kreu IV specifikon rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve dhe strukturave për menaxhimin e rastit. Kreu V detajon më qartë se më parë financimin e shpenzimeve për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

Më konkretisht, në nenin 27 përshkruhen rolet dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve për fëmijë, publikë dhe privatë. Ato janë si më poshtë:

1. Punonjësit dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë, publike ose private, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.
2. Drejtuesi i ofruesit të shërbimeve cakton personin përgjegjës, që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni:
 - a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet për zhvillimin e zbatimit të PIM-it për fëmijën, si dhe në ofrimin e shërbimeve për fëmijën dhe familjen;
 - b) Mban kontakte të vazhdueshme me PMF-në, i cili shërben si menaxher rasti për fëmijën, ndaj të cilit ofrohen shërbimet në kuadër të PIM-it, si dhe njofton PMF-në në lidhje me çdo situatë që ndikon në mirëqenien, zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës.
- *VKM Nr. 353, dt.12.06.2018 "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative"*³

Ky vendim lidhet me rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive apo njësive administrative dhe përbërjen e tij. Konkretisht, sipas vendimit anëtarët e GTN – së janë:

- a) Përfaqësues të strukturave të policisë,
- b) Përfaqësues të strukturave të shërbimeve sociale,
- c) Përfaqësues të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar,
- ç) Përfaqësues të strukturave shëndetësore,
- d) Përfaqësues të strukturave të drejtësisë,
- e) Përfaqësues të organizatave jofitimprurëse
- dh) Çdo specialist tjetër, që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës.

Vendimi përcakton rolin e PMF-së në njësinë administrative për identifikimin e strukturave që ofrojnë shërbime dhe për organizimin dhe drejtimin e mbledhjeve të GTN-së. Gjithashtu, në këtë vendim parashikohen rregullat për caktimin e anëtarëve, thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes, funksionet e GTN-së për vlerësimin e plotë të rastit, miratimin, zbatimin dhe rishikimin e planit individual të mbrojtjes, si dhe mbylljen e rastit.

³ <http://fëmijët.gov.al/al/ep-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-353-datë-12.6.2018.pdf>



- VKM Nr.148, datë 13.03.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”⁴.

Fusha e veprimit të këtij vendimi është përcaktimi i bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

Ky vendim është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrat e bashkëpunimit mes organizmave të mësipërm për të përmbushur të drejtat e fëmijës, por edhe për mbrojtjen e tyre. Ndër të tjerash, qëllimi i bashkëpunimit është edhe ngritja dhe koordinimi i shërbimeve sociale, rehabilituese, riintegruese e ligjore për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe të fëmijëve të tjerë vulnerabël, me fokus të veçantë parandalimin. Gjithashtu, është e rëndësishme që të shihen në këtë vendim format e bashkëpunimit me OJF-të në nivel vendor, duke qenë se roli i tyre është i rëndësishëm për ofrimin e shërbimeve të munguara nga sektori publik, të përshkruara në Kreun 1, pika 4.

- VKM Nr.565, datë 29.9.2018 “Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”⁵

Ky vendim përcakton rolin e ministrisë përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës për të bashkërenduar punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës me ministritë e tjera përgjegjëse për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Gjithashtu, parashikon format e bashkëpunimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve me: a) bashkitë dhe b) strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në nivel njësie administrative.

- VKM Nr.465, datë 03.07.2019 “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet”⁶

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme dhe/ose të paligjshme në internet dhe përcakton rolin e ASHMDF-së, Ministrisë së Arsimit dhe ministrisë përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në parandalimin dhe menaxhimin e këtij fenomeni. QKM duke qenë institucione që kanë qendra ditore për fëmijët, ku mund të kenë akses në

⁴<http://fëmijët.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-148-datë-13.3.2018.pdf>

⁵<https://shëndetësia.gov.al/ep-content/uploads/2019/02/VKM-nr.-565-datë-29.9.2018.pdf>

⁶<https://www.unicef.org/albania/media/2096/file/VKM%20Nr.%20465.%20datë%203.7.2019.pdf>



internet janë të detyruar të njohin dhe të zbatojnë këtë vendim, si dhe të bashkëbëjnë me struktura të tjera në rastet, kur evidentojnë se një sipërmarrës apo institucion tjetër nuk i përmbahet këtij vendimi.

- *Vendimi Nr. 635, datë 26.10.2018 “Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer vepër penale”.*⁷

Ky vendim rregullon veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, për trajtimin e fëmijës, që është nën moshën për përgjegjësi penale dhe që dyshohet apo ka kryer një vepër penale. Duke qenë se QKM-të ofrojnë shërbime edhe për të miturit në konflikt me ligjin është e rëndësishme që të bashkëbëjnë me PMF-në dhe struktura të tjera për të zbatuar këtë vendim. Në këtë vendim parashikohet, ndër të tjera, se strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me Njësinë e Vlerësimit e Referimit të Rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, vlerësojnë rastin, duke marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 18/2017. Në rastin kur vlerësohet se janë të pamjaftueshme seancat e këshillimit ndaj prindërve të fëmijës, ato mund të marrin masa për aftësim prindëror sipas përcaktimeve ligjore (Pika 9)

- *VKM Nr. 129, datë 13.03.2019 “Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”*⁸

Ky vendim është i rëndësishëm pasi përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht në sektorin formal dhe informal, përfshirë fëmijët në situatë rruge, si dhe rolet e përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse.

Fokusi i këtij vendimi është në identifikimin proaktiv të fëmijëve të situatë rruge dhe të shfrytëzuar ekonomikisht. Kështu përshkruan rolin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e skuadrave të terrenit të strukturave të shërbimeve shoqërore pranë bashkive.

Me rëndësi është pika 4, në të cilën thuhet: “Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki shkëmben me drejtorinë vendore të policisë/komisariatit e policisë që mbulon zonën dhe inspektoratin, që mbulon fushën e punës, kontaktet e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës dhe të shërbimeve sociale ditore e rezidenciale për fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge, si dhe kontaktet e anëtarëve të skuadrave të terrenit”.

- *Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*⁹

Qëllimi i ligjit është përcaktimi i rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Fusha e veprimit e këtij

⁷ <https://shëndetësia.gov.al/ëp-content/uploads/2019/02/VKM-nr.-635-datë-26.10.2018.pdf>

⁸ <https://dosja.al/shfrytëzimi-ekonomik-i-fëmijëve-këshilli-i-ministrave-del-me-vendim-special-cfarë-duhet-të-bëjë-policia/>

⁹ <http://differentandequal.org/ëp-content/uploads/2019/09/Liqj-nr-121-dt.-21.11.16.pdf>



ligji janë: a) llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

b) rolet dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij. Është një ligj thelbësor për të gjithë profesionistët që punojnë në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale pranë bashkive dhe qendrave komunitare multifunksionale si dhe për OJF-të që ofrojnë shërbime të tilla.

Sipas këtij ligji :

- “Shërbime komunitare”, janë shërbimet që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditor apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- “Shërbime parashoqërore”, janë shërbimet që përfshijnë informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ofruesit e shërbimeve, ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore.
- “Shërbime në familje”, janë shërbime të kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale
- “Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line” është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokolleve të hartuara dhe të miratuara.

Shërbimet e këshillimit me telefon ose on-line janë të rëndësishme në çdo kohë, por veçanërisht në periudha të kufizimit të lëvizjes dhe të izolimit.

Në nenin 15 shpjegohen shërbimet që ofrohen në qendrat komunitare si ditore dhe gjysmëditore, ndërsa larmishmëria e shërbimeve që mund të ofrohen lidhen me shërbime për higjienën personale, kujdesin shëndetësor, edukimin, rehabilitimin psiko-social, kalimin e kohës së lirë në komunitet, fuqizimin e individit/familjes, si dhe çdo shërbim tjetër i nevojshëm, sipas nevojave të identifikuara të përfituesit.

Gjithashtu, në nenet 30 deri 38 shpjegohen rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe veçanërisht në nenin 36 përcaktohet roli i bashkisë dhe ngritja e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë njësive administrative, çdo 6.000 deri në 10.000 banorë.

Gjatë dy viteve të fundit kanë hyrë në fuqi një sërë aktesh nënligjore që detajojnë më tej veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve, kriteret për t'i përfituar ato, llojshmërinë e shërbimeve dhe elementë të tjerë të rëndësishëm.

- VKM 518 datë 4.9.2018 për “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.”¹⁰

Ky vendim përcakton:

- kriteret dhe procedurat për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial sipas llojit të shërbimit dhe kategorisë përkatëse të përfituesit dhe
- masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.

Vendimi specifikon më tej llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe i ndan ato në:

- shërbime parashoqërore: informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi on-line;
- shërbime në komunitet: shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.
- shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

Shërbimi multifunksional përmban një shumëllojshmëri shërbimesh, siç përcaktohet në pikën 6 të Kreut II.

Shërbimi multifunksional siguron:

- shërbime për rehabilitimin fizik dhe psiko-social;
- këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin, punësimin, edukimin shëndetësor, arsimin, argëtimin;
- fuqizimin e individit/familjes;
- çdo shërbim tjetër të nevojshëm të identifikuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Po kështu, në këtë vendim shpjegohet krahas të tjerash ofrimi i shërbimit në qendra ditore dhe gjysmëditore, shërbimet parashoqërore, shërbimet në familje. Aktualisht, qendrat multifunksionale ofrojnë një llojshmëri shërbimesh, duke përfshirë këtu dhe qendra ditore për fëmijët dhe/ose të moshuarit, shërbime të specializuara, shërbime informimi dhe këshillimi si ato parashoqërore. Prandaj, kjo VKM është ndihmuese për të kuptuarit dhe zbatimin e të gjitha llojeve të shërbimeve të ofruara nga qendrat multifunksionale. Me interes të veçantë për punonjësit e qendrave komunitare multifunksionale janë pikat 33, 34, 35 dhe 36, ku përcaktohen kriteret e përfitimit të shërbimit në qendrat komunitare multifunksionale.

Grupet përfituese nga kjo VKM janë: të moshuarit në nevojë, fëmijë, gra viktime të dhunës në familje, persona me aftësi të kufizuar, të moshuar, viktime të trafikimit, të pastrehët, viktime të abuzimit seksual, përdorues të drogave, individë në nevojë për shërbime psiko-sociale.

¹⁰ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/09/04/518>



Udhëzimi 911, data 27.12.2018, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”¹¹

Modeli i Qendrave Komunitare Shumëdisiplinore është mbështetur në ligjin 121/2016 për shërbime të kujdesit shoqëror, për të adresuar sa më mirë nevojat e identifikuar të komunitetit vendor. Modeli është hartuar me tiparet e shërbimeve fleksibël, të rëndësishme dhe të pranueshme nga vetë komuniteti vendor ku do të zbatohet. Ngritja e një Modeli të tillë i shërben ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në mënyrë uniforme, në zbatim të dispozitave specifike të ligjit nr. 121/2016, por duke respektuar edhe kuadrin ligjor që lidhet me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Standardet janë një instrument i rëndësishëm i matjes së cilësisë së shërbimit, sepse ato përcaktojnë një nivel të ofrimit të shërbimit. Standardet ndihmojnë dhe në procesin e identifikimit të pengesave gjatë zbatimit të tyre, si edhe në identifikimin e nevojave për burime shtesë. Në këtë rast, ky informacion përdoret edhe për të ngritur një çështje apo advokuar për të pasur më shumë burime në dispozicion. Ato u referohen shërbimeve parashoqërore, shërbimeve në qendrat komunitare, përfshirë dhe qendrat e zhvillimit në sektorin publik dhe jopublik. Secili prej tyre shoqërohet me një sërë kriteresh për përmbushjen e standardit.

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve që u referohen këto standarde janë:

- Çdo fëmijë dhe familjet e tyre, duke përfshirë edhe të miturit në konflikt me ligjin;
- Të rriturit me probleme sociale për shkak të rikthimit nga emigrimi;
- Të rriturit, me probleme sociale që u përkasin grupeve vulnerabël, si: romë dhe egjiptianë;
- Të rriturit me probleme sociale për shkak të varfërisë, të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike;
- Viktimat e dhunës dhe të trafikimit.

Standardi 4: Për rastet individuale, QKSHD aplikon qasjen e “Menaxhimit të Rastit” për t’u siguruar që mbështetja është e gjithanshme, e plotë dhe e përshtatshme.

Veçanërisht standardi 4 tregon për mënyrën se si realizohet Menaxhimi i Rastit dhe ofrimi i shërbimit në mënyrë të gjithanshme, si dhe procedurat që duhet të ndjekin punonjësit e qendrës komunitare shumëdisiplinore. Natyrisht, të gjitha standardet janë të rëndësishme.

[Ligji nr.47, datë 23.07.2018 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.](#)

Ligji ka si qëllim: a) parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme dhe b) garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe të çdo individi, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3 të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje.”

¹¹<http://www.shërbimi-social.gov.al/ep-content/uploads/2020/08/Udhëzimi-nr.911-datë-27.12.2018-Për-miratimin-e-standardeve-të-ofrimit-të-shërbimeve-të-kujdesit-shoqëror-në-qendrat-komunitare-shumëdisiplinore-5.pdf>



Është e rëndësishme që ligji të njihet nga profesionistët e shërbimeve shoqërore, duke përfshirë këtu strukturat e shërbimeve shoqërore në bashki dhe njësi administrative, si dhe profesionistët e qendrave komunitare multifunkionale. Ligji trajton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor dhe masat e ndryshme të mbrojtjes.

- [Urdhër nr. 101, datë 21.02.2020 "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit \(psv\) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit \(MKR\)](#)¹²

Qëllimi i këtij urdhri vlen më shumë për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Procedurat standarde të veprimit, përshkruajnë tërësinë e veprimeve dhe hapave thelbësorë që duhet të planifikohen, koordinohen, zbatohen, monitorohen dhe vlerësohen rregullisht, për ofrimin e kujdesit dhe ndihmës së duhur në situata të dhunës në familje dhe/ose dhunës me bazë gjinore.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjitha nivelet e tyre, konsiderohen anëtarë shumë të rëndësishëm të MKR-ve dhe madje janë të përfshirë edhe në atë pjesë të Ekspertit Teknik Ndërdisciplinar që aktivizohet menjëherë për çdo rast të paraqitur (i quajtur ndryshe edhe "Eksperti bërthamë").

Në kuadrin e fuqizimit të familjes me rëndësi për profesionistët është që të njihen me përgjegjësitë e personelit shëndetësor në parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje si dhe udhëzimet që duhet të ndjekin për të identifikuar, referuar dhe ekzaminuar raste të tilla.

- [Ligji 57/2019 për "Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"](#)¹³

Ligji i ri për asistencën sociale, që ka hyrë në fuqi në vitin 2019, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.

Ligji ka për qëllim: a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;

b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre;

c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;

ç) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

¹² http://www.sherbimi-social.gov.al/ep-content/uploads/2020/08/Urdh%C3%ABr_101_21.02.2020.pdf

¹³ <http://www.sherbimi-social.gov.al/ep-content/uploads/2019/09/asistenca-sociale-ne-kuvend-1-2.pdf>



Ky ligj është i rëndësishëm për t'u njohur nga të gjithë profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke qenë se një pjesë e fuqizimit të familjeve realizohet nëpërmjet programeve të asistencës sociale. Ligji parashikon llojet e përfituesve dhe të përfitimeve të programeve të asistencës sociale (Kreu II dhe III), kriteret dhe procedurat e përfitimit nga programet e asistencës sociale (Kreu IV) dhe rolet e institucioneve përkatëse për drejtimin dhe administrimin e programeve të asistencës sociale (Kreu V).

- *Ligj nr. 27/2019 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar¹⁴*

Ky është një ligj themeltar për funksionimin e shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Në këtë ligj përshkruhet organizimi i sistemit shëndetësor, llojet e profesionistëve të shëndetësisë dhe detyrimet e tyre për edukimin në vazhdim. Edhe pse si ligj lidhet më shumë me profesionistët e shëndetësisë, gjithsesi sugjerohet që të njihen me këtë edhe profesionistët e shërbimeve shoqërore, pasi i ndihmon në proceset e referimit të rasteve dhe vlerësimit të tyre.

- *Paketa Bazë e Shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor*

Duke qenë se vetë ligji për kujdesin shëndetësor është i kufizuar, për të orientuar më mirë profesionistët dhe atyre që punojnë në fuqizimin e familjes, vjen Paketa Bazë e Shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor. Në këtë paketë përshkruhen në mënyrë të detajuar të gjitha shërbimet që ofrohen nga qendrat shëndetësore, me të cilat bashkëpunojnë më shpesh profesionistët e shërbimeve shoqërore. Gjithashtu, në brendësi të dokumentit dhe në Shtojcat e tij paraqitet lista e shërbimeve shëndetësore që duhet të ofrohen për të rriturit dhe për fëmijët nga QSH-të dhe rolet e mjekut të familjes dhe infermierit të familjes për ofrimin e këtyre shërbimeve.

- *Ligji 44/2012 "Për shëndetin mendor"¹⁵*

Ligji për shëndetin mendor përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Ky ligj është i rëndësishëm për profesionistët që punojnë për fuqizimin e familjes për t'u njohur me të drejtat e njerëzve me probleme të shëndetit mendor dhe mënyrat e trajtimit të tyre. Gjithashtu, në këtë ligj përshkruhen llojet e shërbimeve ku ofrohet kujdes për shëndetin mendor, të cilan ndahen në: shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor; shërbimet komunitare të shëndetit mendor; shërbimet ambulatorë të specializuara; shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër dhe institucionet mjekësore të posaçme. Profesionistët e shërbimeve shoqërore do të

¹⁴<http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190513145923ligji%20nr.%2027.%20dt.%208.5.2019.pdf>

¹⁵https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_Për_shendetin_mendor.pdf



duhet të njihen dhe të bashkëpunojnë me këto shërbime, për çështjet e shëndetit mendor të të rriturve dhe fëmijëve/adoleshentëve.

- *Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*

Ky ligj në përmbajtjen e tij përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionet e njësive vendore.

Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

Neni 24 është ai që lidhet më shumë me shërbimet sociale, sipas të cilit: bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj¹⁶.

➤ **Protokolle dhe standarde për periudhën e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19**

Situata e krijuar nga pandemia e Covid-19 ishte një fenomen i paprecedent për të gjithë botën. Të gjitha shtetet kanë nxjerë shumë shpejt udhëzime dhe urdhra për të parandaluar përhapjen e virusit. Në këtë kontekst edhe shteti shqiptar nxorri disa udhëzime të cilat ishin dhe vazhdojnë të jenë dinamike, për shkak të luhatjes së numrave të të infektuarve dhe nevojës për të vazhduar me ofrimin e shërbimeve të ndryshme, si ai arsimor, shërbimet shëndetësore dhe natyrisht shërbime të kujdesit shoqëror. Disa nga udhëzimet në vazhdim janë të fazës së izolimit dhe bërjes së punës nga shtëpia ose kryesisht me anë të përdorimit të teknologjisë. Ndërsa disa të tjera janë relevante deri sot, pasi masat vazhdojnë të jenë në fuqi.

- *Udhëzimi nr 253, datë 10.04.2020 “Për menaxhimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”¹⁷.*

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe veprimeve konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijës për menaxhimin e rasteve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19. Sipas këtij udhëzimi, strukturat e mbrojtjes së fëmijës, mbështesin, ndërgjegjësojnë, informojnë fëmijët dhe familjet e tyre rreth situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19 për masat parandaluese, shenjat dhe simptomat për identifikimin e sëmundjes,

¹⁶ https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Për_vetëqeverisjen_vendore.pdf

¹⁷ <https://www.unicef.org/albania/media/2761/file/Udhëzim%20nr%20253.pdf>



rrugët e referimit të strukturat shtetërore, numrat e emergjencës dhe si të aksesojnë shërbimet e ofruara në territorin ku jetojnë. Gjithashtu, në këtë udhëzim kërkohen që ata të përshtasin aktivitetet e tyre duke komunikuar më shumë në telefon ose me mënyra të tjera të komunikimit në distancë. PMF-të duhet të jenë vetë të pajisur me leje qarkullimi dhe mjetet e nevojshme për të ruajtur distancën fizike dhe për të respektuar kushtet e tjera të vendosura nga situata e krijuar.

Ky dokument është shumë i rëndësishëm për orientimin e aktiviteteve të PMF-ve. Ai udhëzon për mënyrën se si duhet të kryhet vlerësimi dhe monitorimi i rasteve të fëmijëve në mbrojtje me nivele të ndryshme të rrezikut. Gjithashtu, udhëzon punonjësit për rastet e fëmijëve që mund të jenë në rrezik për shkak të arsyeve të lidhura me prekjën nga Covid-19, si p.sh.: rastet kur prindërit janë të hospitalizuar, kur nuk kanë akses në shërbime etj. Udhëzimi përcakton procesin për marrjen e masave të mbrojtjes dhe për bashkëpunimin e nevojshëm të PMF-së me struktura të shëndetit publik dhe me shërbime të tjera psikologjike.

- *Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 157, datë 10.03.2020 "Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga Covid-19 të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror"*¹⁸

Ky është një urdhër i hershëm i MSHMS, i cili ka udhëzuar aktivitetet e personelit shëndetësor dhe atij social për periudhën e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Në këtë urdhër parashikohet pezullimi/ndalimi i vizitave nga të afërm dhe familjarë në institucione rezidenciale. Në raste specifike vizitat mund të lejohen vetëm me miratimin e titullarit të Shërbimit Social Shtetëror. Gjithashtu, thuhet se institucionet e përkujdesit shoqëror duhet të marrin masa të shtuara higjieno-sanitare, deri në dezinfektimin e ambientit, nëse kjo do të rekomandohet nga strukturat përgjegjëse. Pjesa tjetër e urdhrit lidhet me bashkëpunimin e nevojshëm mes mjekëve dhe personelit shëndetësor dhe institucioneve të përkujdesit shoqëror.

- *Vendim nr.236, datë 19.3.2020 'Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19'*¹⁹

Në këtë vendim përcaktohen proceset për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë nga strukturat shtetërore, në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga Covid-19. Sipas vendimit, ofrimi i asistencës, konsiston në dërgimin e pagesave mujore që subjektet përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale nga sigurimet shoqërore dhe në dërgimin e produkteve, ushqimore e joushqimore, minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mësipërme, për llogari të tyre. Grupet e përfituesve të këtij shërbimi janë:

¹⁸ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/49/ed5ca6ff-c466-438e-8f4c-082ad87f3334>

¹⁹ <https://juristionline.al/ep-content/uploads/2020/04/VKM-nr.-236-dt.-19.03.2020-%E2%80%9CP%C3%ABr-marrjen-e-masave-p%C3%ABr-ofrimin-e-asistenc%C3%ABs-n%C3%AB-banes%C3%AB-ndaj-shtresave-n%C3%AB-nevoj%C3%AB-n%C3%AB-kushtet-e-epidemis%C3%AB-s%C3%AB-shkaktuar-nga-COVID19.pdf>



a) personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë dhe që bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:

- Familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;
- Personat me aftësi të kufizuara;
- Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.

b) personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj, bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:

- Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë;
- Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit

- *Urdhër nr. 633, 7.11.2020 "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura"*²⁰

Sipas këtij urdhri ndalohen grumbullimet me më shumë se 10 persona në mjediset e mbyllura apo të hapura, si: tubimet, ceremonitë, mbledhjet partiake etj. Ky urdhër ka sjellë një ndryshim në mënyrën e zhvillimit të mësimit në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, ku grupet e nxënësve detyrimisht janë me më pak nxënës. Gjithashtu, QMF-të që kanë qendra ditore ose gjysmë-ditore, si ato afterschool (pas shkolle), duhet të përshtasin mjediset e tyre në mënyrë që të respektohen këto masa.

- *Udhëzuesi për përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë*²¹

Në këtë udhëzues paraqiten kriteret e përgjithshme, rregullat dhe përjashtimet për përdorimin e barrierave mbrojtëse (maskave) me qëllim parandalimin e përhapjes së Covid-19. Udhëzuesi thekson se përdorimi i maskave duhet të konsiderohet si plotësues i masave të tjera mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së Covid-19, siç është ajo e ruajtjes së distancës me 1.5 deri në 2 m dhe higjiena e duarve. Gjithashtu, shpjegon përdorimin e saktë të maskës dhe përjashtimet që mund të bëhen nga përdorimi.

- *Urdhër nr 333, datë 20.05.2020 "Për miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik për 'Masat ndaj Covid-19 që duhet të marrin institucionet e kopshteve dhe çerdheve"*²²

Ky është një dokument i rëndësishëm për QKM-të që kanë qendra ditore, pasi masat që duhet të respektohen nga ata janë të ngjashme me këto të çerdheve dhe kopshteve. Udhëzuesi përcakton rregullat për marrjen dhe sjelljen e fëmijëve nga institucionet, për strategjitë e distancimit shoqëror gjatë qëndrimit në institucion duke përfshirë këtu specifikime për numrin e karrigeve dhe fëmijëve, kujdesin për higjienën, mënyrën e përgatitjes së ushqimit dhe shërbimi i tij dhe rregulla për prindërit dhe drejtuesit.

- *Udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020 - 2021*²³

²⁰ <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/11/Urdher-nr.633-2.pdf>

²¹ <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/10/1163-1UDHEZUES-MBI-PERDORIMIN-E-DEYRUESHEM-TE-MASKAVE-NE-AMBJENTET-SHTËPIAKE-1.pdf>

²² <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/05/Urdher-Nr.333.pdf>

²³ <https://www.ascap.edu.al/ep-content/uploads/2020/08/Udhëzuesi-për-fillimin-e-vitit-shkollor-2020-2021.pdf>



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rekomandon këtu që të kihet kujdes për nxënësit për hyrjen dhe daljen nga ambientet e shkollës, ku orari për hyrjen e nxënësve në shkollë rregullohet sipas një grafiku, hartuar nga drejtoria e shkollës dhe nën monitorimin e mësuesve të kujdestarisë ditore/javore. Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose atë të familjes verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo. Ata duhet të jenë të pajisur me dezinfektantë dhe masa mbrojtëse dhe në brendësi të klasës duhet të ruhet distanca prej 1.5m. Është një udhëzues që vjen në ndihmë për rregullimin e hapësirave, të vendosjes së fëmijëve, kujdesin për ta dhe për mësuesit dhe procese të mëtejshme në mjedisin shkollor.

V. PROCESI EKZISTUES I MENAXHIMIT TË RASTIT DHE MEKANIZMAT LOKALË TË REFERIMIT NË SITUATËN E PANDEMISË COVID-19

“Menaxhimi i Rastit” është metodologjia që siguron hap pas hapi ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij,” përkufizim sipas pikës 11, neni 4, VKM nr.578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të Menaxhimit të Rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes” dhe Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Si i tillë Menaxhimi i Rastit për Mbrojtjen e Fëmijëve është pjesë e shërbimeve thelbësore që nuk mund të ndalet papritmas, por që kërkon përshtatje me situatën e re të krijuar prej emergjencës shkaktuar nga Covid-19 duke mbajtur në konsideratë parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Në një situatë kur shkollat dhe institucionet e kujdesit për fëmijë u mbyllën (veçanërisht periudha mars-shtator 2020) dhe gjendja e mbingarkuar e jetesës ku familjet janë të mbyllura, prindërit dhe kujdestarët të stresuar për shumë arsye (p.sh. humbja e vendit të punës) fëmijët u ekspozuan ndaj rrezikut të rritur të abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit.

Nga ana tjetër fëmijët mund të përjetojnë vdekjen e kujdestarit të tyre ose mund të ndahen nga familjet e tyre për shumë arsye, përfshirë arsyet shëndetësore prej infektimit dhe zbatimit të masave të mbrojtjes nga Covid-19. Këto rreziqe janë shpesh të fshehura, brenda familjeve dhe larg syve të komuniteteve, institucioneve gjë që e bën më të vështirë të identifikohen fëmijët e prekshëm pa vizitat në familje ose forma të tjera të identifikimit nga ana e strukturave përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve për shkak të kufizimeve të reja që lidhen me Covid-19.

Që të identifikojmë masat e adaptuara dhe përgjigjet e përshtatura ndaj rreziqeve të reja ndaj të cilave ekspozohen fëmijët gjatë pandemisë, në kontekstin e masave të marra dhe gatishmërisë nga pushteti lokal, duhet të analizojmë situatën /veprimet ekzistuese të reagimit nga strukturat e agjencitë, specifikisht shërbimet sociale,



shëndetësore dhe arsimore për menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe familjeve në nevojë në bashkitë e synuara të projektit.

Në këtë mënyrë sigurojmë konsiderata për përshtatjen e ndërhyrjeve të menaxhimit të rastit dhe ofrimit të shërbimeve gjatë pandemisë Covid-19 dhe kuptojmë më mirë rolin e rëndësishëm të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në situata emergjente si ajo e Covid-19, por jo vetëm.

Kur flasim për një mekanizëm efektiv të Menaxhimit të Rastit, natyrshëm merren në konsideratë këto komponentë :

- Baza ligjore, udhëzime që ndihmojnë përshtatjen e procesit të MR me emergjencën.
- Struktura (strukturat bazuar në ligj dhe burimet njerëzore)
- Fuqia punëtore dhe siguria
- Ofrimi i shërbimeve, financimi i tyre
- Koordinimi ndërinstytucional
-

5.1..Mjaftueshmëria e Udhëzimeve ligjore në kushtet e pandemisë COVID-19

Siç është theksuar më lart, konsiderata kryesore ku bazohet ky vlerësim është fakti që Menaxhimi i Rastit të Mbrojtjes së Fëmijëve si pjesë e shërbimeve thelbësore nuk mund të ndalet papritmas, qoftë dhe për shkak të emergjencave si kjo e Covid-19 por që natyrisht kërkon përshtatje me kontekstin e ri të diktuar nga emergjenca.

Në këtë prizëm udhëzimet e dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Menaxhimin e Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (paraqitur te konteksti ligjor) dhe ofrimin e shërbimeve për familjet, shërbyen për adaptimin e veprimeve në ushtrimin e aktivitetit të përditshëm për ofruesit e shërbimeve dhe natyrisht dhe për PMF-të.

Natyrshtëm pyetja që ngrihet është: - a ishin të mjaftueshëm këto udhëzime për të orientuar punën e PMF-ve dhe punonjësve socialë në procesin e menaxhimit të rastit duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijëve ?

Udhëzimi nr 253, datë 10.04.2020 “Për menaxhimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19 është udhëzimi që përcakton procedurat dhe veprimet konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijës për menaxhimin e rasteve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19. Udhëzimi është një dokument shumë i rëndësishëm për orientimin e aktiviteteve të PMF-ve. Ai udhëzon për mënyrën se si duhet të kryhet vlerësimi dhe monitorimi i rasteve të fëmijëve në mbrojtje me nivele të ndryshme të rrezikut, se si të përshtasin aktivitetet e tyre duke komunikuar më shumë në telefon ose me mënyra të tjera të komunikimit në distancë. Ai udhëzon punonjësit për rastet e fëmijëve që mund të jenë në rrezik për shkak të arsyeve të lidhura me prekjen nga Covid-19, si p.sh.: rastet kur prindërit janë të hospitalizuar, kur nuk kanë akses në shërbime, etj. Udhëzimi



përcakton procesin për marrjen e masave të mbrojtjes dhe për bashkëpunimin e nevojshëm të PMF-së me struktura të shëndetit publik dhe me shërbime të tjera psikologjike duke respektuar masat e sigurisë përmes mjeteve të nevojshme mbrojtëse dhe duke ruajtur distancën fizike.

Lidhur me mjaftueshmërinë e këtij udhëzimi, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe drejtues të shërbimit social përmes intervistave janë shprehur si më poshtë:

!! Udhëzimi ishte ndihmues në atë situatë të re për të gjithë ne, por duhej shoqëruar me një protokoll pune më të qartë. (dr. Shërbimi social)

!! Pandemia na gjeti të papërgatitur. Pati një konfuzion mbi mënyrën se si do të vepronim, por edhe vetë si punonjës ndiheshim të frikësuar. Udhëzimi na dha disa orientime, por duhej të kishte dhe veprime të parashikuara për t'u përgjigjur situatave që ne ndeshëm gjatë menaxhimit të rastit në kushtet e emergjencës. (PMF)

Pra, duket që udhëzimi edhe pse ishte një orientim i mirë për PMF-të në atë situatë konfuzioni duhej të shoqërohej me një protokoll pune konkret, ku të parashikoheshin më shumë situata dhe veprimet konkrete të PMF-ve në procesin e Menaxhimit të Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

5.2. Strukturat

Kuadri ligjor për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri përcakton edhe autoritetet përgjegjëse dhe mekanizmat mundësues për aplikimin në praktikë të parashikimeve ligjore. Në listën e autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen shoqërore dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë përfshihen: ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe shëndetësore; Shërbimi Social Shtetëror; Inspektoriati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror; Bashkia; Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, punonjësi social.

Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë si dhe strukturat përgjegjëse specifikohen më tej në Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” në Republikën e Shqipërisë, i miratuar më datë 23.2.2017. Neni 34 pika 2 përcaktojnë si më poshtë:

Niveli	Struktura	Emërtimet e mekanizmave/strukturave Kombëtarë Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues
Kombëtar	Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues	a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror; b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.



Qendror	Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror	a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës; b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës c) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.
Vendor	Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor	a) bashkia; b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë njësive administrative; d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Tabela 2. Mekanizmat dhe strukturat përgjegjëse për MF në RSH

Nga ana tjetër, që me miratimin e ligjit të parë për mbrojtjen e fëmijës (2010), pushteti vendor ka marrë një rol të rëndësishëm për garantimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, gjë që përforcohet dhe detajohet edhe më tej më ligjin e ri (18/2017).

Kuadri ligjor (Neni 52 i Ligjit nr. 18/2017) parashikon se çdo bashki dhe njësi administrative me mbi 3000 fëmijë ngrihet ad-hoc Grupi Teknik Ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës, me pjesëmarrje të aktoreve kryesorë të arsimit, shëndetësisë, policisë, shërbimeve sociale dhe aktorë të tjerë, të cilët identifikohen si të rëndësishëm për rastin që trajtohet. Ky mekanizëm ligjor mundëson një ndërhyrje ndërsektoriale të koordinuar. Detyrimi që kanë tashmë të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët për raportim të çdo rasti të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit apo dhunës të fëmijët, përfshin mësuesit dhe psikologët e shkollave, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private (duke parashikuar edhe sanksione në rast mospërbushje të detyrimit)

5.2.1 Situata e strukturave në terren

Për të kuptuar se si është situata në terren, u mbledhën të dhëna pikërisht mbi gjendjen e strukturave dhe stafeve përkatëse në raport me MF. Nga intervistat me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve (Aneksi 1) në bashkitë e përfshira në vlerësim rezultoi se në bashkitë Shkodër, Korçë, Lezhë, Fier, Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (PMF-ja) është pjesë e Njësisë për mbrojtjen e fëmijëve në bashki, pra ende në këto bashki nuk janë ngritur NJVNR-të pranë NJA, pjesë e të cilave duhet të jetë dhe PMF. Ndërsa në



bashkinë Tiranë, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është tashmë pjesë e Njesisë Administrative dhe numërohen 27 PMF përpos 3 PMF-ve në strukturën e NJMF-së në bashkinë Tiranë. Në këtë bashki struktura e NJVNR-së është në proces ristrukturimi. Në bashkinë Durrës ka 3 PMF respektivisht, 1 PMF pranë NJMF-së në bashkinë Durrës dhe 2 PMF në Njësitë administrative Rrushbull dhe Sukth

Bashkia	Nr.PMF-ve/NJMF	Nr.PMF/NJA
Tiranë	3	27
Shkodër	1	
Korçë	2	
Durrës	1	2
Lezhë	1	
Fier	1	

Tabela 3. Shpërndarja e PMF-ve në bashkitë përkatëse

Në të gjitha këto bashki janë ngritur qendra komunitare multifunksiionale. Nga informacioni i marrë nga intervistat me punonjës socialë të këtyre qendrave, rezultoi se roli i tyre nuk kufizohet vetëm në ofrimin e shërbimeve, por edhe në atë çka mund të konsiderohet si Menaxhim Multidisiplinar të rasteve ose pjesëmarrje në Menaxhimin Ndërsektorial të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Ndërkohë që rastet në përgjithësi do të menaxhohen nga qendrat që zbatojnë modelin komunitar multifunksional, përveçse në disa situata specifike, për shembull kur kemi të bëjmë me çështje për mbrojtjen e fëmijëve dhe kur përfshihet Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve. Këto qendra duhet të bashkëpunojnë me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve për të garantuar që planet e mbrojtjes të hartuara nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve të zbatohen me qëllim që fëmijët të mbrohen siç duhet. Pra, kur kemi të bëjmë me rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve /Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve në Bashki apo Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Njësitë Administrative (në bashkitë ku PMF është pjesë e NJVNR-së në NJA), që menaxhojnë rastin e fëmijës në rrezik, proces ku punonjësi social i qendrës komunitare multifunksionale është pjesëmarrës në GTN-së për Menaxhimin e Rastit.

Bazuar në vlerësimin e nevojave që PMF, përcakton së bashku me anëtarët e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), punonjësi social merr përgjegjësitë e caktuara në zbatimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës.

Ja si shprehen disa punonjës socialë gjatë intervistave tona:

“Gjatë gjithë pandemisë, sidomos në periudhën e karantinës kemi ofruar ndihma për banorët e zonës, ku ndodhet qendra jonë.” (P. Social QKM)

“Ndjekja e rasteve ka qenë e vështirë, pasi ndeshëm në një mendësi indiferente të banorëve, e cila manifestohej duke mohuar ekzistencën e rrezikut nga Covid-19, duke rrezikuar veten, familjen, por edhe ne si punonjës socialë. Për këtë arsye na u desh që krahas ndihmave, të ndërgjegjësonim individët, familjet mbi rrezikun e Covid-19 dhe masat mbrojtëse ndaj tij.” (P. Social QKM)

Edhe pse këto qendra komunitare multifunkionale (QKM) luajnë një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm në ofrimin e shërbimeve, ndërgjegjësimin komunitar dhe specifikisht në procesin e parandalimit dhe trajtimit të rasteve të fëmijëve me nivel të ulët deri në të mesëm të rrezikut, për sa është trajtuar më sipër evidentohet fakti që Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve pranë Njesisë për mbrojtjen e fëmijëve në bashkitë respektive mbetet figura kryesore që mban peshën e menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, pasi dhe në bashkitë si Tirana që tashmë i kanë inkorporuar PMF-të në strukturën e NJVNR-së, pranë NJA-ve, takimet e GTN-së zhvillohen pranë NJMF-së në bashki nën suportin e NJMF-së specifikisht për raste të rrezikut të lartë. Natyrshëm lind pyetja: A kanë pasur mundësi PMF-të të ushtrojnë funksionin kryesor të tyre atë të adresimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë kësaj periudhe? (specifikisht në periudhën mars-qershor 2020)

Përgjigjet e marra lidhur me këtë pyetjeje, nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve janë si më poshtë:

- ¶¶ *Në këtë situatë pandemie, jemi përfshirë dhe fokusuar totalisht në dhënie dhe ndihmave emergjente për familjet” (PMF)*
- ¶¶ *Rastet kishin pasur nevojë për mua, - këtë më thanë kur dola në punë pas izolimit dhe u takova me ata” (PMF)*
- ¶¶ *Ndihem e lodhur me punën, pasi jam e vetmja PMF për gjithë zonën dhe në kohën e karantinës e kam pasur të vështirë të mbaj kontaktet me rastet” (PMF)*

Mungesa e punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve në nivelin e njësive administrative ka bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve ligjore në këtë nivel, për rrjedhojë ajo që konfirmohet nga të gjithë PMF-të e intervistuarat rezulton se janë angazhuar drejtpërdrejt në shpërndarjen e ndihmave emergjente për familjet vulnerabël në situatën e emergjencës duke sfumuar funksionin dhe përgjegjësinë kryesore të PMF-së, adresimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Përfshirja e PMF-ve në shpërndarjen e ndihmave për individët dhe familjet në nevojë solli:

- *Ezaurim të stafëve të PMF-ve duke u angazhuar në shërbime të tjera në situatë emergjente;*
- *Shkëputjen nga ndjekja e rasteve në proces menaxhimi dhe mosgjurmimi të rasteve të reja, ku bëjnë përjashtim trajtimi i rasteve emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilat duket se kanë qenë prioritet ndër detyrat funksionale të PMF-së atë të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;*
- *Ofrimin e shërbimeve jo me në qendër fëmijën apo sipas nevojave të rastit.*

Nga ana tjetër mungesa e strukturave si NJVNR-të dhe burimeve njerëzore të tyre, përfshirë PMF-të parashikuar tashmë në ligjin 121 për "Shërbimet shoqërore" ka vënë në pikëpyetje edhe ofrimin e shërbimeve për familjet në nevojë.

Kjo situatë konfirmohet edhe nga diskutimet në fokus-grupe si dhe intervistat e thelluara me persona kyç në sistem.

!! *Ne jemi përpjekur të bëjmë më të mirën, por e kemi pasur të vështirë të identifikojmë raste apo të vlerësojmë nevojat e rastit në zonat e largëta" (IK.dr. shërb.soc)*

!! *Në ditët e para të karantinës, mbeta vetëm para kërkesave të qytetarëve, pasi kemi staf të limituar, i cili ishte karantinuar sipas udhëzimit të qeverisë" (IK.dr. shërb. social)*

!! *Në fshatin ku banoj unë nuk ka punonjës për mbrojtjen e fëmijëve" (prind FG)*

5.2. Identifikimi/raportimi dhe Vlerësimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

Lidhur me çështjen e identifikimit të rasteve dhe trajtimit të tyre, konstatohet se burimet më efikase kanë qenë përmes linjave telefonike të vëna në dispozicion nga bashkitë respektive, aktorët lokalë (Policia, Dr.ShSSHR, OJF-të) sidomos nga linjat e ndihmës on-line, siç është Alo 116.

!! *Krijua grup komunikimi në Ëhatsapp, që menaxhohej nga drejtori i shërbimit social në bashki për të koordinuar punën"(PMF)*

!! *Numrat tanë të kontaktit i bëra publikë për të marrë raportime mbi rastet e fëmijëve në nevojë"(PMF)*

!! *U ngrit linja e gjelbër pas 1 muaji nga fillimi i Pandemisë" (DR shërb.soc.bashki)*

Në të gjitha bashkitë në fokus të këtij vlerësimi ka pasur një adaptim të rrugëve për identifikimin, raportimin e rasteve në nevojë. Diktuar nga situata, janë vënë në dispozicion linja telefonike apo shërbimi on-line në ndihmë të individëve në nevojë por pa i specifikuar si linja të ndihmës për fëmijë, për këshillim psikologjik apo thjesht linja të raportimit të nevojave të qytetarëve.

Sa i përket numrit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës janar-qershor 2020 ka rezultuar një situatë paksa kontradiktore midis asaj që referojnë PMF-të dhe shërbimet e tjera.



!! *Nuk kemi pasur rritje të numrit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, por kemi pasur rritje të nevojave për rastet që kemi në proces” (PMF)*

!! *Gjatë mësimin on-line, shpesh nxënësit na referojnë shqetësime lidhur me situatën dhe ndihen të frikësuar” (mësuese)*

!! *Telefonatat e fëmijëve dhe familjarëve lidheshin me informimin mbi Covid-19 dhe rrezikun e infektimit”(infermiere pranë NJVKSH)*

!! *Kemi marrë referime të shtuara nga fëmijët që kërkojnë ndihmë, pasi ndihen të frikësuar apo stresuar mbi situatën e Covid-19 dhe kërkojnë këshillim psikologjik”(Alo 116)*

Ajo që bie në sy dhe ngjall diskutim është se PMF-të referojnë një situatë normale të numrit të rasteve të identifikuar gjatë periudhës janar-qershor 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019-ës. Pra të gjitha PMF-të në bashkitë respektive deklarojnë që numri i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nuk është rritur.

Nga ana tjetër perceptohet një ekspozim më i madh i fëmijëve ndaj dhunës dhe abuzimit në kushtet e izolimit apo problemeve ekonomike sociale, me të cilat u përballën dhe vazhdojnë të përballen familjet si pasojë e situatës së Covid-19.

!! *Në procesin e shpërndarjes së pakove ushqimore, kemi identifikuar raste të fëmijëve të abuzuar, që nuk i kishim konstatuar më parë”(PMF)*

!! *Personeli shëndetësor më ka referuar raste të fëmijëve që ndiheshin të frikësuar dhe në ankth”(PMF)*

Pra, del qartazi që ka raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, por e kanë pasur të vështirë të identifikohen apo të kenë akses në shërbime. Kjo për shumë arsye si izolimi, mungesa e internetit, telefonave, distancë e largët nga shërbimet, mungesa e informacionit mbi rrugët e reja të referimit etj.

Numri i njëjtë, madje në disa raste rënia e pretenduar e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, vërejtur në periudhën mars - prill 2020, ngjan shumë me rëniet e regjistruara në periudha të tjera të vitit, kur shkollat janë zakonisht të mbyllura, të tilla si gjatë pushimeve të verës. Gjatë mbylljes së shkollës dhe pezullimit të shumë aktiviteteve të kohës së lirë / sportive / rekreative, fëmijët thjesht nuk janë më në kontakt me shumë prej atyre që zakonisht vërejnë dhe raportojnë shenja abuzimi. Në të vërtetë, një numër i konsiderueshëm provash tregon se shkollat në çdo kohë, luajnë një rol të madh në raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve

Ndërsa masat e kufizimit të Covid-19 kanë prishur disa mekanizma referimi dhe raportimi për fëmijët në nevojë për mbrojtje, intervistat sugjerojnë gjithashtu që linjat e

ndihmës për fëmijët janë një nga shërbimet më pak të prekura të mbrojtjes së fëmijëve dhe prej tyre marrim një informacion tjetër lidhur me referimet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Sipas linjës ALO 116, ka pasur një rritje të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

!! *Referimet nga fëmijët që kërkojnë ndihmë, lidhen jo vetëm me frikën dhe ankthin mbi situatën e Covid-19, por kemi pasur raste të shtuara të fëmijëve që raportojnë për ngacmime seksuale në faqet on-line, të cilat i kemi trajtuar dhe adresuar” (40% janë fëmijë shqiptarë nga 6500 raportime për ngacmime seksuale on-line, të bëra nga fëmijë në mbarë botën) (Alo 116)*

Përveç sigurimit të përdoruesve me udhëzime për të shprehur shqetësimet e tyre, linjat e ndihmës të krijuara nga institucionet publike apo ato jopublike gjithashtu ofruan referime të drejtpërdrejta në shërbime të tjera mbështetëse, siç janë: shërbimet sociale, strehimi dhe kujdesi shëndetësor etj. Linjat e ndihmës për fëmijët janë një komponent integral i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Duke qenë pa pagesë, të hapura dhe të arritëshme 24 orë në 365 ditë të vitit dhe konfidenciale, ato ofrojnë këshilla dhe informacione për fëmijët dhe adoleshentët për një sërë temash.

Shërbimet on-line apo në distancë, treguan se duhet të jenë të synuara për një grup të veçantë të popullatës, si në rastin e linjave të ndihmës për fëmijët ose linjave të ndihmës për dhunën në familje veçanërisht në situatë emergjence.

Linjat e ndihmës për fëmijë janë relativisht të lehta dhe me kosto efektive për t'u vendosur. Ndryshe nga mekanizmat e tjerë zyrtarë të raportimit të mbrojtjes së fëmijëve (përmes shkollave, policisë, autoriteteve të mbrojtjes së fëmijëve ose qendrave të kujdesit shëndetësor), linjat e ndihmës për fëmijët ofrojnë një avantazh të qartë, pasi ato ofrojnë një kanal konfidencial për fëmijët që të flasin hapur dhe të marrin këshilla pa u ballafaquar me formalitetet e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Linjat e ndihmës për fëmijët gjithashtu paraqesin mundësinë për të identifikuar raste dhune nga popullata veçanërisht të prekshme të fëmijëve, që kanë qasje shumë të kufizuara të arrijnë te mekanizmat zyrtarë të raportimit.

Sfida qëndron në faktin se linjat e ndihmës për fëmijët varen nga disponueshmëria e rrjeteve të besueshme telekomunikuese (ose interneti) brenda një zone, si dhe aksesit i individëve në telefon ose internet. Shumica e fëmijëve të marginalizuar, shpesh në një rrezik në rritje të dhunës dhe abuzimit, natyrisht që kanë më pak akses në pajisje dhe internet, përfshirë fëmijët që jetojnë në rrugë, fëmijët emigrantë, fëmijët e shfrytëzuar dhe të trafikuar, fëmijët e privuar nga liria ose që jetojnë në institucione.

5.3. Vlerësimi i rasteve të identifikuar

Vlerësimi është një tjetër proces i rëndësishëm që përcakton nëse një fëmijë është në nevojë për mbrojtje. Edhe në këtë aspekt për shkak të zbatimit të masave të sigurisë të përcaktuara nga udhëzimi për Menaxhimin e Rasteve të fëmijëve në kushtet e pandemisë COVID-19, PMF-të kanë hasur vështirësi.

Disa nga vështirësitë e evidentuara nga PMF-të janë si më poshtë:



!! *Vlerësimi i rasteve bëhej i vështirë, sidomos nga pamundësia e kontaktit ballë për ballë me fëmijën dhe familjen”(PMF)*

!! *Kemi riskuar për rastet në rrezik të menjëhershëm, kur na është dashur të marrim masën e mbrojtjes së menjëhershme”(PMF)*

!! *Vlerësimin e rasteve e kemi realizuar nga kontakti me telefon me fëmijën dhe familjarët apo nga informacioni i marrë nga burime të tjera, por kur e kemi parë të arsyeshme kemi realizuar edhe takime apo vizita ballë për ballë duke rrezikuar shumë”(PMF)*

Procesi i vlerësimit në situatën Covid-19 duket se i ka orientuar PMF-të drejt prioritarizimit të rasteve sipas nivelit të rrezikut duke i dhënë përparësi rasteve me rrezik të lartë. Pikërisht nga të gjitha intervistat rezulton se në trajtimin e rasteve me rrezik të lartë/të menjëhershëm, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve ka qenë në ushtrimin e përgjegjësisë kryesore të tij, siç është adresimi i mbrojtjes së fëmijëve, marrja në mbrojtje e tyre. Rastet e tjera për hir të kontekstit të emergjencës janë trajtuar si gjithë rastet e tjera në nevojë duke ofruar shërbime bazike dhe jo të personalizuar sipas nevojës së fëmijës.

Nisur nga konteksti mund të themi që është sfumuar përgjegjësia kryesore e PMF-ve ajo e adresimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ku përjashtim bëjnë rastet në rrezik të menjëhershëm.

5.4.Planifikimi dhe ofrimi i shërbimeve

Procesi i Menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje është një proces që koordinohet nga PMF në rolin e menaxherit të rastit, por që kërkon kontributin e disa sektorëve të tjerë, si: shëndetësia, arsimit, punësimi, strukturave të policisë, ojf-ve etj Kontributi kryesor i këtyre aktorëve është që përmes Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), të hartojnë planin individual të mbrojtjes, ku planifikohet edhe ndërhyrja apo mbështetja për fëmijën dhe familjen.

Gjatë periudhës së pandemisë, veçanërisht gjatë karantinës nga intervistat me aktorët kyç, rezulton se GTN-të janë mbledhur vetëm në rastet emergjente, kryesisht on-line.

!! *Jemi mbledhur on-line, por kemi pasur vështirësi në mbajtjen e këtyre takimeve si prej problemeve teknike, por edhe pamundësisë së aktorëve për të marrë pjesë” (PMF)*

!! *Personalisht kam përshtypjen se takimet on-line të GTN-ve, nuk e kanë efektin e takimeve ballë për ballë”(PMF)*



“ Kishte raste që në GTN mungonin përfaqësues të institucioneve për shkak të infektimit të tyre apo të familjarëve me Covid-19” (dr. shërb. social)

Nga pohimet del qartë nevoja që mbrojtja e fëmijëve të jetë prioritet i institucioneve përgjegjëse dhe duhet të merren masat për mbarëvajtjen e të gjitha proceseve të MR, përfshirë kushtet teknike, logjistike, stafin rezervë, etj. Ofrimi i shërbimeve është një nga sfidat më të mëdha në situatë emergjente. Pavarësisht nga dispozitat e kuadrit ligjor, udhëzimet e dala për situatën e Covid-19, ofrimi i shërbimeve ka hasur vështirësi gjë që e konfirmojnë intervistat.

“ Jemi gjendur para trysnisë se si të ndihmojmë fëmijët dhe familjet, ndërkohë që vetë ishim shumë të frikësuar”(PMF)

“ Në ofrimin e ndihmave për familjet, ndeshëm në një mendësi mohuese, indiferente të banorëve, e cila manifestohej duke mohuar ekzistencën e rrezikut nga Covid-19 duke rrezikuar veten, familjen por edhe ne si punonjës socialë. Për këtë arsye na u desh që krahas ndihmave të ndërgjegjësonim individët, familjet mbi rrezikun e Covid-19 dhe masat mbrojtëse ndaj tij” (P.social.QKM)

“ Kishte raste që familjet nuk na e hapnin derën, kërkonin tu linim ushqimet në derë dhe të largoheshim”(PMF)

“ U gjendëm të përfshirë në ndarjen e ndihmave për familjet, pa marrë asnjë lloj udhëzimi dhe me mjete të kufizuara për t'u mbrojtur nga Covid” (PMF)

“ Ka qenë një periudhë shumë sfiduese, pasi çdo ditë që shkoja në punë një nga kolegët ose bashkëpunëtorët mungonte për shkak të infektimit të tij apo të familjarit duke shtuar ankthin, por edhe ngarkesën për ne”(P.soc.DRSHSSH)

“ Lidhur me rastet e fëmijëve në situatë emergjente, ku na është dashur të marrim masën e menjëherëshme të mbrojtjes, mund të them se ka pasur një angazhim më të mirë të institucioneve përgjegjëse në GTN, por kemi hasur vështirësi në vendosjen e fëmijës në qendër rezidenciale për një qëndrim më afatgjatë. Kjo për faktin se qendra ose nuk kishte plotësuar kushtet e sigurisë sipas udhëzimit, ose thjesht nuk e ofronte shërbimin duke u justifikuar në mënyra të ndryshme. Si rezultat kemi dështuar në një rast duke i kthyer fëmijët në familje” (PMF)

Nga intervistat e realizuara me PMF-të dhe drejtues të shërbimeve sociale në këto bashki (Aneksi 1), punonjës socialë pranë QKM-ve (Aneksi 2) apo institucioneve të tjera pjesë e mekanizmit të referimit, rezulton se ka pasur vështirësi në ofrimin e këtyre

shërbimeve veçanërisht në fazën e hershme të emergjencës që u shoqërua me karantinën.

Këto vështirësi lidhen me frikën nga infektimet, ngarkesë në rritje të punës, apatinë e ofruesve të shërbimeve të caktuara, informacionet kontradiktore dhe nevojën për të përshtatur praktikën dhe procedurat e MR në një kontekst të ri emergjence dhe në një afat të shkurtër kohor.

Për rastet e fëmijëve në situatë emergjente, strukturat dhe ofruesit e shërbimeve kanë treguar përgjegjshmëri më të lartë lidhur me pjesëmarrjen në GTN, ofrimin e strehimit emergjent të fëmijës në qendrat që e ofrojnë këtë shërbim, por ka pasur raste që MR ka dështuar dhe PMF e ka pasur të pamundur vendosjen e fëmijës në qendër rezidenciale për një qëndrim më afatgjatë, parashikuar në masën e mbrojtjes së menjëhershme për shkak të hezitimit të këtyre të fundit.

Gjatë ofrimit të shërbimeve ka rrezik të shtuar për punonjësit socialë, fëmijët dhe familjet, që të bien në kontakt me virusin, në këto kushte shëndeti, siguria, shëndeti mendor dhe mirëqenia psiko-sociale e ekipit të menaxhimit të rasteve duhet të jetë prioritare.

Në shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë, u konstatua se ofrimi i ndihmës bëhej bazuar në kërkesën e ardhur drejt numrave telefonikë në dispozicion pra pa patur mundësinë për një vlerësim të situatës socio-ekonomike të familjes. Kjo situatë konfirmohet edhe nga intervistat e thëlluara me persona kyç në sistem.

!! *Nevojat e familjeve ishin të mëdha, por sfida jonë më e madhe ishte prioritarizimi i këtyre nevojave”(Dr.sh.soc.bashki)*


!! *Ka pasur raste që situata ekonomike e familjes nuk përputhej me informacionin e dhënë për familjen”(PMF)*

!! *Ndodhi ajo që të gjithë u përfshimë në ofrimin e ndihmave dhe shpesh ka pasur mbivendosje shërbimesh”(P.soc QKM)*

Nga realizimi i fokus-grupeve me fëmijë dhe prindër përfitues të shërbimeve në qendrat komunitare multifunktionale (Aneksi 4) kemi mundur të marrim opinionin e fëmijëve dhe prindërve mbi nevojat e tyre gjatë pandemisë dhe shërbimet e marra. Në fokus-grup morën pjesë 30 fëmijë dhe 30 prindër përfitues të shërbimeve pranë QKM-ve.

Më poshtë jepet grafiku i nevojave të fëmijëve dhe prindërve mbi bazën e një votimi për opsionet e sugjeruara nga pyetsori i përdorur në fokus-grupet me fëmijë dhe prindër. Këto janë rezultate që lidhen vetëm me grupet e fëmijëve dhe të prindërve të përfshirë në këto fokus-grupe (Aneksi 4).

Nevojat e prindërve/fëmijëve në kushtet e emergjencës



Grafiku 1. Nevojat e fëmijëve/prindërve në kushtet e emergjencës

Nga rezultatet vërejmë se fëmijët dhe prindërit kanë prioritarizuar këto nevoja:

Fëmijët	Prindërit
aksesin në mësimin on-line	mjete monetare
Nevojë/dëshirë për t'u argëtuar , të mos ndahen nga prindërit	ushqim e veshje
të kenë mundësi, akses në referimin e shqetësimeve	fëmijët të kenë akses në mësimin on-line
të kenë suport shëndetësor dhe të jenë të sigurt	fëmijët të kenë suport shëndetësor dhe të jenë të sigurt
nevoja për këshillim psikologjik	të parandalohet abuzimi i fëmijëve gjatë pandemisë
ushqime dhe veshje	të kenë mundësi, akses në referimin e shqetësimeve
të parandalohet abuzimi i fëmijëve gjatë pandemisë	të kenë një strehë/banesë
	këshillim psikologjik

Tabela 4. Prioritarizimi i nevojave sipas fëmijëve/prindërve

Nga renditja shohim se ka këndvështrim të ndryshëm nga fëmijët dhe prindërit mbi nevojat e tyre, ato që për fëmijët janë prioritare si: nevoja për argëtim, për të qëndruar me prindërit nuk konsiderohen nga prindërit prioritare. Prindërit nga ana tjetër konsiderojnë nevoja prioritare mbështetjen monetare, ushqimin, veshjen, apo strehimin që për fëmijët renditen në fund ose nuk janë votuar fare (si strehimi).

Lidhur me nevojën e trajtimit për shëndetin mendor, nuk janë prononcuar as prindërit, as fëmijët. Të rriturit, në këtë rast prindërit mendojnë sipas statusit të tyre, por që një pjesë e nevojave të përcaktuara prej tyre janë larg nevojave reale që perceptojnë fëmijët dhe që për ata janë shumë të rëndësishme. Kjo nënvizon dhe një herë faktin se sa i rëndësishëm është procesi i vlerësimit të nevojave gjatë MR dhe përfshirja e fëmijëve në këtë proces, përndryshe do të kemi vlerësim nevojash jo të saktë dhe planifikim shërbimesh jo në interesin më të lartë të fëmijës.

Gjatë diskutimit në FG fëmijët shprehën se vështirësinë për ndjekjen e mësimëve on-line e lidhin me mungesën e internetit dhe të mjeteve digjitale, ndërsa dëshirën për t'u argëtuar për të luajtur me shokët dhe shoqet në lagjen e tyre e lidhin me vështirësinë në zbatimin e masave të mbrojtjes. Ajo që vërehet te përgjigjet e fëmijëve, është se një pjesë e vogël deklarojnë nevojat ushqimore apo rritjen e agresivitetit brenda familjes, gjë që mund të justifikohet me pjesën e stigmës ndaj këtyre fëmijëve, nëse pranojnë vështirësitë ekonomike apo prezencën e dhunës në familje.

Disa përgjigje të fëmijëve:

!! *Më merrej fryma, më mungonin shokët dhe shoqet”(FG)*

!! *Kur fillova të dal m'u duk sikur dola nga burgu, sikur kisha shkuar në Paris”(FG)*

!! *Sa herë që luaja me shoqen në lagje, kisha frikë mos infektoja gjyshen dhe prindërit kur të kthehesha në shtëpi” (FG)*

!! *Shpesh nuk futesha në mësimin on-line, pasi telefonin e kishte mami me vete ne punë”(FG) Babi im u mërzit shumë se nuk mund të dilte për të mbledhur kanaçe”(FG)*

!! *Gjatë gjithë ditës qëndroja vetëm në shtëpi me vëllain”(FG)*

!! *Prindërit e mi shpesh grindeshin për ushqimet”(FG)*

Prindërit vërehet se kanë prioritete të tjera, ndër të cilat bien në sy vështirësitë ekonomike, nevoja ushqimore, frika, ankthi për shkak të situatës, papunësia, mungesa e informacionit mbi shërbimet e tjera dhe pak prej tyre shprehen për rritje të agresivitetit, gjë që përsëri mund të ndikohet nga rritja e stigmës ndaj tyre. Pohime të prindërve:

!! *Kam qenë shumë në ankth për familjen time, humbja e punës më demoralizoi dhe më filluan shqetësimet e ankthit”(FG)*

!! *Jemi 7 vetë në familje, 5 fëmijë në shkollë, nevojat kryesore tonat janë ushqimi i përditshëm, fëmijët të ndjekin mësimin, kemi vetëm një celular në shtëpi, kush ta marrë më parë”(FG)*

!! *Me thënë të drejtën nuk i zbatojmë dot të gjitha ato që duhet, nuk kemi mundësi të blejmë maska dhe ato të tjerat” (FG)*


!! *Stresi te vinte më shumë se nuk dije ku të drejtoheshe për të zgjidhur një hall, të gjithë ishin të izoluar ose punonin nga shtëpia”(FG)*

!! *Fëmija im u bë shumë agresiv, pasi qendra ku e dërgoja për terapi u mbyll përkohësisht”(FG)*

Përveç suportit ekonomik, dalin mjaft të nevojshme, argëtimi, suporti psikologjik ndaj fëmijëve dhe prindërve, akses për të referuar shqetësimet, informimi mbi situatën, masat mbrojtëse dhe mbi shërbimet për të cilat ata kanë nevojë.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur shërbimet që kanë marrë fëmijët dhe familjet.

Shërbimet që morën gjatë pandemisë (mars-qershor 2020)



Grafiku 2. Shërbimet që kanë marrë fëmijët dhe familjet

Nga grafiku vërehet se shërbimet që kanë marrë janë bazike dhe e shprehur në përqindje kemi këto rezultat: ndihmë ekonomike 83%, mjete higjienike 73%, pako ushqimore 56%, mjete për të aksesuar mësimin on-line 40% e fëmijëve dhe “paga e luftës” 10% e prindërve. Duket që ofrimi i ndihmës është diktuar nga kërkesat që vijnë nga individët në linjat e ndihmës, por pa realizuar vlerësime për nevojat e fëmijës dhe të familjes.

Nga ana tjetër mbetet për t’u diskutuar fakti nëse këto mjete monetare, mund t’i quajmë shërbime apo thjesht ndihmë monetare, për të kaluar krizën. (shërbimet parashikohen në ligjin 121 për shërbimet shoqërore)

Nga informacioni i marrë nga fokus-grupet, identifikohet kjo situatë në ofrimin e shërbimeve:

- Ka munguar vlerësimi i nevojave të fëmijëve dhe familjeve për shërbime, veçanërisht në nivel njësie administrative, e cila do të mundësonte shërbime të orientuara drejt nevojave reale të fëmijëve dhe familjeve.
- Ofrimi i shërbimeve është fokusuar dhe mjaftuar në mbështetjen me pako ushqimore, veshje, pako higjieno-sanitare (të konsideruarit e këtyre mjeteve monetare si shërbime, vlen për t’u diskutuar)
- Ka pasur mungesë të burimeve njerëzore, duke bërë që punonjës si PMF-të të përfshihen më shumë në shpërndarjen e pakove ushqimore, sesa në ndjekjen e monitorimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, këtu përjashtohen rastet emergjente, të cilat janë ndjekur nga PMF-të
- Çështje të mbrojtjes së fëmijëve, duket se nuk kanë marrë vëmendjen e duhur përderisa PMF-të janë angazhuar në shpërndarjen e ndihmave për familjet ndërkohë që duhet të kishin prioritet menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, kjo mund të ketë ardhur edhe për mungesë mirorganizimi

- të punonjësve sidomos në ato bashki, ku ka një numër të konsiderueshëm punonjësish socialë pranë qendrave komunitare,*
- *Ajo që evidentohet është nevoja për të qartësuar rolet e gjithsecilit në një situatë emergjente, e informimit ndërsektorial mbi mënyrat e adaptuara të identifikimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve në kushtet e pandemisë dhe zbatimi i përgjegjësive që i ngarkon ligji për mbrojtjen e fëmijëve.*
 - *Nevoja për të trajnuar stafin për ofrimin e shërbimeve në kushte emergjente.*
 - *Ka munguar hartëzimi i shërbimeve shumë-sektoriale, përfshirë azhurnimet mbi shërbimet e adaptuara të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbime të tjera, për të cilat mund të ketë më shumë kërkesë gjatë Covid-19 (kujdesi shëndetësor, kujdesi alternativ, shërbime mbështetëse të bazuara në komunitet, ndihmë në para, shërbime bazike (që lidhen me të ushqyerit, higjienën, veshje), shërbimet ligjore etj)*
 - *Për pasojë, shërbimet më së shumti gjatë emergjencës marrin formën e ndërhyrjeve të atypëratyshme (ad hoc) dhe jo atë të shërbimeve sistematike, që do të thotë se ato nuk janë të planifikuara dhe të integruara; janë të vështira për t'u arritur, mbështeten në kapacitete dhe burime të pamjaftueshme*
 - *Nuk është marrë në konsideratë mendimi i fëmijëve, jo vetëm në ofrimin e shërbimeve, por edhe në çdo vendimarrje tjetër që ka të bëjë me ata.*

6. Shërbimet shëndetsore dhe arsimore

Ndër shërbimet më të rëndësishme për realizimin e së drejtës për shëndet dhe edukim, janë edhe shërbimet shëndetësore dhe ato të edukimit. Këto shërbime janë të qenësishme për të garantuar mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve në një situatë të jashtëzakonshme, siç është pandemia.

Në ligjin nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, përshkruhet organizimi i sistemit shëndetësor, llojet e profesionistëve të shëndetësisë dhe detyrimet e tyre për edukimin në vazhdim

Duke qenë se vetë ligji për kujdesin shëndetësor është i kufizuar, paketa bazë e shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor e parashikuar në këtë ligj ndihmon për të orientuar më mirë profesionistët e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe fuqizimit të familjes që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve dhe fuqizimin e familjes. Në këtë paketë përshkruhen në mënyrë të detajuar të gjitha shërbimet që ofrohen nga qendrat shëndetësore, me të cilat bashkëpunojnë më shpesh profesionistët e shërbimeve shoqërore. Gjithashtu, në brendësi të dokumentit dhe në shtojcat e tij, paraqitet lista e shërbimeve shëndetësore që duhet të ofrohen për të rriturit dhe për fëmijët nga QSH-të dhe rolet e mjekut të familjes dhe infermierit të familjes për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ligji për arsimin, por edhe udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020-2021, vënë theksin te rëndësia e koordinimit të shërbimit psiko-social të shkollës me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve për të adresuar raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje edhe gjatë periudhës së emergjencës.



Për të parë se si është realizuar ky bashkëpunim në situatën e Covid-19 dëshmojnë intervistat e thelluara (Aneksi 2) me përfaqësues nga shëndetësia, mjekë familjeje, infermierë, punonjës socialë pranë qendrës komunitare të shëndetit mendor (QKSHM 2) dhe njësisë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH 2) (shih tabelën nr.2), por edhe aktorë të tjerë si punonjës socialë pranë linjave të ndihmës, QKM-ve dhe vetë PMF-të (Aneksi 1)

!! *Detyra jonë parësore është ofrimi i kujdesit shëndetësor, ndonëse nuk kemi pasur raste të fëmijëve të dhunuar për të referuar”(mjeke)*

!! *Një fëmijë referoi nevojën për të bërë disa analiza mjekësore, por që kishin vështirësi ekonomike dhe prindërit nuk dinin ku të shkonin, pasi ishte periudhë karantine”(Punonjësi social, linja e ndihmës për fëmijë)*

!! *Me shërbimin shëndetësor kemi bashkëpunuar për të bërë tamponet për dy raste të fëmijëve në rrezik të menjëhershëm, të cilët u vendosën në qendra rezidenciale” (PMF)*

Ajo që vërehet nga informacioni i marrë nga intervistat është fakti se koordinimi mes ofruesve të shërbimeve sociale dhe strukturave të shëndetësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

!! *Kur kisha një rast për ta vendosur në qendër rezidenciale sipas udhëzimit, telefonova 127-ën për t'i bërë tamponin fëmijës dhe m'u desh t'i shpjegoja mjekes detyrimin e tyre sipas udhëzimit 253”(PMF)*

!! *Shpesh nuk kishim informacion mbi situatën e infektimit në familje apo komunitet” (PMF)*

Intervistat tregojnë që ka munguar edhe përditësimi i informacionit mbi zonat më të prekura, apo komunitetet më të rrezikuara nga Covid-19, zona të cilat në procesin e ofrimit të ndihmës frekuentohen shpesh nga punonjësit socialë apo PMF-të, gjithashtu strukturat shëndetësore nuk janë informuar me adaptimet ligjore për mbrojtjen e fëmijëve dhe përgjegjësitë e tyre në kushtet e pandemisë.

Përsa i përket arsimit, nga intervistat me punonjës të shërbimit psiko-social, me mësues, IK (Aneksi 3) rezulton se fokusi i drejtuesve të shkollave, i mësuesve apo i shërbimit psiko-social ka qenë zbatimi i masave të sigurisë në periudhën kur mësimi filloi në klasë sipas një grafiku të caktuar, ndërsa gjatë karantinës mësuesit kanë qenë të angazhuar në zhvillimin e mësimin on-line. Shërbimi psiko-social përmes numrave të kontaktit të punonjësve të këtij shërbimi është munduar të ofrojë këshillim për fëmijët e shkollës, të cilët kanë marrë inisiativën të referojnë shqetësimin e tyre, por pa shkuar më tej, lidhur kjo me reprimin e rastit pranë NJMF/PMF apo polici kur bëhet fjalë për fëmijë në nevojë për mbrojtje.

- !! *Mjaft nxënës nuk patën akses në mësimin on-line, ose për mungesë interneti, ose nuk kishin mjete fare”(mësuese)*
- !! *Kemi pasur një mbingarkesë të madhe, pasi kur sëmurej një kolege duhej ta zëvendësonim, vonesë që e solli miratimi në portal i mësuesve zëvendësues”(mësuese)*
- !! *Kur filloi mësimi në klasë, pamë që disa fëmijë kishin ndryshuar sjellje, ishin bërë më agresivë ose disa më të tërhequr, më të mbyllur. Për këto raste kemi biseduar me psikologun e shkollës”(mësuese)*
- !! *Nuk kemi pasur koordinimin me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve apo shëndetësinë për referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë”(mësuese)*
- !! *Disa shoqata ndihmuan një numër fëmijësh më në nevojë me tableta për t’u mundësuar mësimin on-line”(mësuese)*

Nga këto intervista, por edhe nga intervistat e mëparshme me aktorët përgjegjës të mbrojtjes së fëmijëve, rezultojnë se koordinimi ka çaluar. Kjo ka sjellë më pak raste të identifikuar dhe referuara, veprime të copëzuara, sporadike ku gjithsecili bën përpjekjet brenda kornizës së tij, nuk ka shkëmbim informacioni dhe përditësim të mënyrave të adaptuara të identifikimit/referimit të rasteve në situatën e emergjencës. Për rrjedhojë është dëmtuar mekanizmi i referimit dhe nuk ka informacion për ecurinë e rastit.

Mësuesit kanë hasur shumë sfida në realizimin e mësimit on-line, sfida që vijnë nga infrastruktura por dhe nga aftësitë personale, siç mund të jetë përshtatja e mësimit përmes platformave on-line, përdorimi i teknologjisë, mungesa e ndërveprimit me nxënësit, etj.

- !! *Nuk kisha njohuri mbi platformat on-line, nuk dija si t’i përdorja, si të krijoja grupin dhe të ndaja materialet, e kam pasur shumë të vështirë”(mësuese)*
- !! *Dhënia e mësimit përmes portalit akademia.al duhet të përshtatet për të gjithë nivelet e nxënësve, vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve arrijnë ta përvetësojnë mësimin”(mësuese)*
- !! *Nxënësit na referonin që nuk e kuptonin mësimin siç e kuptonin në klasë, ata ishin pasivë dhe të papërqendruar”(mësuese)*
- !! *Më humbi dëshira për të ndjekur mësimin ngaqë mbeta pas me mësimin”(fëmijë FG)*



!! *Ndonjëherë nuk futesha në mësim sidomos në mëngjes, më dukej i mërzitshëm”(fëmijë FG)*

Intervistat pohojnë rëndësinë e trajnimit të mësuesve mbi zhvillimin e mësimin on-line, metodat e të nxënies interaktiv, përshtatja e mësimin sipas moshës dhe zhvillimit të fëmijëve, etj. Ndërsa për fëmijët merr rëndësi sigurimi i mjeteve të nevojshme për të pasur akses në mësim on-line, aplikimi i metodave interaktive për ti përfshirë të gjithë fëmijët në proces dhe si të përdorin këto platforma në mënyrë të sigurt për të garantuar mbrojtjen e tyre nga abuzimi on-line.

7. Fondet

Pavarësisht se Menaxhimi i Rastit synon të adresojë nevojat komplekse materiale, shëndetësore, arsimore, ligjore, psiko-sociale, mendore të fëmijës/familjarëve, të strehimit, ai nuk ofron zgjidhje kur mungojnë burimet bazë që mund të ndihmojnë rastin. Menaxhimi i Rastit nuk parandalon ndodhjen e problemeve, por si metodologji dhe praktikë pune e aplikuar nga të gjithë aktorët pjesëmarrës në grupin teknik ndërsektorial, ofron bazën e një strukture për të ndihmuar mbrojtjen e fëmijëve aq më tepër në kushtet e emergjencës shkaktuar nga Covid-19.

Aplikimi i Menaxhimit të Rastit është një praktikë shumë pozitive që ndihmon në identifikimin e burimeve të mundshme, por nuk mund të krijojë vetë burime, pra dështon ose është e suksesshme në varësi të burimeve ose shërbimeve për Referimin e Rastit, ndaj për këtë arsye bashkitë kanë detyrim ligjor që të vendosin me prioritet kostimin dhe buxhetimin e planeve në ndihmë të fëmijëve.

Në kushtet e emergjencës fondet e emergjencës pothuajse në të gjitha bashkitë, u dyfishuan, për t'u ardhur në ndihmë fammiljeve, u bashkëpunua me donatorë dhe OJF ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Në këto buxhete nuk ka pasur një specifikim të dedikuar për MR të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

!! *Mungesa e fondeve na ka limituar në ofrimin e shërbimeve sipas nevojave të fëmijës. Një nënë që sapo ka lindur nuk mund ta ushqejë beben e saj me oriz apo makarona”(PMF)*

!! *Përmes bisedës në telefon me familjarët, kuptonim nevojat e familjes. Prioritet për ne ishte sigurimi i ushqimit. Për shërbimet e tjera të cilat nuk mund t'i ofronim, i referonim pranë strukturave të tjera por që nuk merrnim informacion çfarë ndodhte më tej” (Punonjës social QKM)*

Mungesa e fondeve të posaçme për MR ka bërë që shërbimet e mbrojtjes të limitohen në shërbime që lidhen me mbijetesën e fëmijës, duke konsideruar “luks” ofrimin e



shërbimeve të personalizuar bazuar në nevojat reale të fëmijës që garantojnë të drejtën e tij për mirëritje.

REKOMANDIME

Në një situatë emergjence si Covid-19 por që mund të shkaktohet edhe nga faktorë të tjerë, është domosdoshmëri të kuptohet roli i rëndësishëm i Menaxhimit të Rasteve(MR) të fëmijëve në rrezik dhe rëndësia e vazhdimësisë së MR duke adaptuar veprimet për secilin nga hapat e Menaxhimit të Rastit, në mënyrë që të vazhdojmë të mbështesim fëmijët dhe familjet e tyre.

Modelimi i një mekanizmi lokal efektiv referimi midis shërbimeve kryesore sic janë shërbimet shëndetësore, arsimore dhe të mbrojtjes gjatë situatave emergjente, ka në themel të tij ndarjen e roleve dhe përgjegjësi konkrete të aktorëve të përfshirë në menaxhimin e rasteve dhe koordinimin midis tyre në situatën e emergjencës, por jo vetëm.

6 komponentët kryesorë që duhen përshtatur për të siguruar një mekanizëm efektiv për mbrojtjen e fëmijës në kushtet e pandemisë Covid-19

- Struktura me role dhe përgjegjësi të qarta bazuar në kuadrin përkatës ligjor, hartimi i planeve paraprake të emergjencës për reagimin në periudhë krize për secilin sektor
- Adaptim i procesit të Menaxhimit të Rastit (MR) bazuar në udhëzimet në kontekstin e situatës së emergjencës
- Forcimi i mekanizmit të referimit për mbrojtjen e fëmijëve
- Koordinim midis shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe të mbrojtjes në nivelin kombëtar, vendor dhe komunitar për të realizuar një reagim të procesit të Menaxhimit të Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ndaj rreziqeve të shtuara që gjeneroi Covid-19
- Adaptimi i shërbimeve dhe siguria e punonjësve të përfshirë në MR
- Monitorimi, vlerësimi, kapitalizimi i modeleve pozitive të funksionimit të mekanizmit efektiv të mbrojtjes së fëmijëve në kushtet e pandemisë. Përfshirja e fëmijëve dhe familjeve në proces



1	Struktura me role dhe përgjegjësi të qarta bazuar në kuadrin përkatës ligjor, hartimi i planeve paraprake të emergjencës për reagimin në periudhë krize për secilin sektor (shëndëtimi, arsim, mbrojtja e fëmijëve)
Veprimet kryesore	<p>1. Ngritja e strukturave të NJVNR-së me burime njerëzore të duhura, përfshirë PMF-të, parashikuar tashmë në ligjin nr. 121 për “Shërbimet shoqërore”</p> <p>2. Hartimi i planeve paraprake të emergjencës për reagimin në periudhë krize për secilin sektor (shëndëtimi, arsim, mbrojtja e fëmijëve), i cili duhet të marrë në konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>përshtatjen e infrastrukturës</i> - <i>riorganizimin e stafëve duke parashikuar “stafin në gadishmëri” për zëvendësimet e nevojshme të punonjësve kryesorë</i> - <i>planifikimin dhe financimin e shërbimeve kryesore për fëmijët</i> - <i>modelimin e shërbimeve në distancë duke përfshirë rritjen e digjitalizimit</i> <p>3. Sigurohemi që personeli i sektorëve përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve të jenë të trajnuar për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>identifikimin e hershëm të abuzimit, neglizhencës dhe dhunës ndaj fëmijëve;</i> - <i>referimin dhe dokumentimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve;</i> - <i>komunikimin miqësor me fëmijët;</i> - <i>politikën e mbrojtjes së fëmijës në kushtet e emergjencës.</i> - <i>të punuarit në situatë emergjente dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme (p.sh ndihma e parë psikologjike)</i> <p>4. Të gjithë sektorët duhet të hartojnë dhe miratojnë politikën për mbrojtjen e fëmijëve, e cila duhet të jetë e unifikuar për të garantuar sigurinë e fëmijëve.</p> <p>5. Vendosja e mekanizmave të ankesave të sigurt, të arritshme, miqësore ndaj fëmijëve në të gjithë sektorët dhe në internet.</p> <p>6. Ndërgjegjësimi, shfaqja e mesazheve për mbrojtjen e fëmijëve duke përfshirë:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> - trajtimin e ankthit te fëmijët dhe prindërit - adresimin e stigmës dhe përjashtimit shoqëror që mund të rezultojë nga virusi - e drejta e fëmijëve për të qenë të sigurt - shërbime të disponueshme psiko-sociale, etj <p>7. Shpërndarja e informacionit të saktë shëndetësor përmes aktorëve për mbrojtjen e fëmijëve të tilla, si: rreziku i infektimit, respektimi i masave mbrojtëse, orientimi për shërbimet e nevojshme.</p> <p>8. Mbrojtja e fëmijëve të konsiderohet prioritet nga të gjithë sektorët përgjegjës bazuar në ligj, duke i dhënë rëndësi koordinimit multi-sektorial për të trajtuar shqetësimet e mbrojtjes së fëmijëve lidhur me abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve.</p> <p>9. Siguria dhe mirëqënia e stafit të strukturave/sectorëve përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe ofruesve të shërbimeve. Trajnimi i tyre mbi rreziqet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve gjatë pandemisë Covid-19, përfshirë parandalimin e shfrytëzimit seksual, abuzimit dhe mënyrën e raportimit të sigurt të shqetësimeve.</p>

2	Adaptimi i procesit të Menaxhimit të Rastit
Veprimet kryesore për PMF-të/ supervizorët	<ul style="list-style-type: none"> • Përshtasni kriteret e përparësisë së rasteve sipas udhëzimeve të dala të MSHMS dhe situatës së Covid-19 në vend. • Caktoni nivelet e rrezikut për rastet që keni në menaxhim dhe për rastet e reja të mbrojtjes së fëmijëve.
Për rastet në proces menaxhimi aktual	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeni një rishikim të rasteve aktuale në proces dhe caktoni nivele të reja të rrezikut, nëse ka indikatorë të ndryshuar të ndikuar prej situatës Covid-19. • I jepni përparësi rasteve me rrezik të lartë.



<p>Për të gjitha rastet</p>	<p>PMF-ja dhe mbikqyrësi (përgjegjësi i NJMF-së/dr.Shërbimit social në bashki) duhet të rishikojnë dhe tu japin përparësi të gjitha rasteve të hapura përmes takimeve të cilat mund të ndodhin në distancë nëse “qëndroni në shtëpi”ose “ballë për ballë”kur është e mundur duke respektuar masat e sigurisë.</p> <p>Fillohet me raste me rrezik të lartë duke përdorur pyetjet vijuese për të përcaktuar rastet që do tu jepet prioritet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cila është situata aktuale e fëmijës? A ka pasur ndonjë ndryshim të vogël ose të madh që prek fëmijën dhe/ose kujdestarët e tyre si rezultat i pandemisë? • Cilat janë gjasat që siguria dhe mirëqenia e fëmijës të përkeqësohen për shkak të krizës aktuale? • Çfarë lloji mbështetje kërkon fëmija dhe si do të merren parasysh siguria e fëmijëve dhe PMF-së për secilin veprim të dhënë me përparësi? <p><i>Ofrimi i shërbimeve të MR mund të ketë nevojë të modifikohet në varësi të situatës duke marrë parasysh përshtatjet e mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Takimet “ballë për ballë të realizohen,vetëm nëse janë të sigurta dhe të përshtatshme për fëmijën, familjen dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve (PMF-në). Nëse PMF-ja nuk mund të vizitojë shtëpinë, caktoni si alternativë një vend të sigurt për t’u takuar, mundësisht jashtë ose në një hapësirë të ajrosur mirë. • Përdorni komunikimin telefonik nëse janë të arritshëm për fëmijën dhe familjarët si alternativë për vizitat. Koordinoni me punonjësit e strukturës pranë NJVNR-së në njësitë administrative, me persona të besuar të komunitetit (kryeplaku për NJA, ndërlidhësi i komunitetit për lagjet e qytetit) apo anëtarë të tjerë aktivë e të besuar në komunitet ose vullnetarë për të siguruar ndjekje vetëm nëse është e sigurt dhe e rëndësishme. • Përcaktoni se çfarë burimesh nevojiten për të zbatuar përshtatjet e propozuara (p.sh. kartë telefoni, materialet higjienike, lejet e lëvizjes, shërbimet e referimit etj). • Caktoni një “menaxher rasti” zëvendësues për të menaxhuar rastet, nëse punonjësi për mbrojtjen e fëmijës sëmuret ose nuk është i aftë për të vazhduar punën. • Nëse shërbimet e menaxhimit të rasteve modifikohen gjatë Covid-19, dokumentoni ofrimin e shërbimit të përshtatur, modalitetin dhe përfshijeni si një shtojcë të procedurave të funksionimit të menaxhimit të rastit.
-----------------------------	---



<p>Për rastet me rrezik të lartë/të menjëhershëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Në procesin e menaxhimit të rasteve, ruani mbështetjen për të gjitha rastet me rrezik të lartë. • Në varësi të sigurisë së profesionistëve dhe disponueshmërisë së pajisjeve të sigurisë (dezinfektant, maska, doreza etj) kryeni vizita “ballë për ballë” me rastet më urgjente. • Nëse për shkak të pandemisë, vendosen kufizime në lëvizje, për ekipin e menaxhimit të rasteve duhet të negociohet me autoritetet përgjegjëse për pajisje me leje qarkullimi, për të asistuar në rastet me rrezik të lartë. • Për raste në situatë emergjente kur shihet e nevojshme dhe mundësitë për të mbështetur rastin janë të limituara, kërkohet mbështetja e PMF-ve nga ASHMDF-ja. • Punonjësi rezervë për menaxhimin e rastit duhet të prezantohet te fëmija dhe prindërit (ose në mungesë, i rritur i besuar) në rast se del nevoja që ai do të vazhdojë menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik të lartë. • Vendimet do të duhet të merren nga mbikëqyrësi (përgjegjësi i NJMF/dr.shërbimit social) dhe PMF-ja, rreth mënyrës se si punonjësi zëvendësues do të njihet me rastin, informacionin mbi rastin me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit gjatë kohës së zëvendësimit.
<p>Për rastet në rrezik të mesëm/ulët</p>	<p>Rastet me rrezik të mesëm dhe të ulët duhet të rishikohen dhe t’u jepet përparësi bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nevojat e rivlerësuara të rastit në situatën e pandemisë. • sigurisë së PMF-së. • disponueshmërisë së mjeteve të komunikimit në distancë (celular,karte rimbushëse,internet) • pajisjes me numrin e kontaktit, i cili duhet të ndahet me fëmijën, prindin/ose kujdestarin /ose të rriturin e besuar për të siguruar ndjekjen e rastit me telefon nëse shihet e nevojshme. • mundësinë e mbështetjes nga komuniteti ku jeton fëmija, për të ofruar siguri për fëmijën (personatë besuar si: persona kontakti në komunitet, ndërlidhësat,të afërm, fqinjë, punonjës pranë NJA etj.)
	<p><i>Përshatni kriteret e vlerësimit të rrezikut që marrin parasysh:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija/familja ndikohet drejtpërdrejt nga Covid-19:

<p>Për rastet e reja të identifikuar gjatë pandemisë Covid -19</p>	<ul style="list-style-type: none"> - shqetësimi i shtuar i fëmijëve dhe familjeve; - humbja e një jete në familje; - ndarja e familjes, fëmijë pa kujdesin e prindit apo kujdestarit në shtëpi për shkak të sëmundjes së prindërve/kujdestarëve (hospitalizim i prindërve/kujdestarit), fëmijët jetimë (vdekja e prindërve/kujdestarëve për shkak të sëmundjes), fëmijët e mbijetuar prej infektimit të Covid-19 që mund të refuzohen nga komuniteti por mund të refuzohen edhe nga familja. <ul style="list-style-type: none"> • fëmija/familja ndikohet indirekt nga Covid-19: <ul style="list-style-type: none"> - familje që kanë dhunë në familje, - dhunë seksuale dhe me bazë gjinore, - fëmijë që janë martuar në moshë të hershme, - adoleshente shtatzëna, - fëmijë në rrezik trafikimi, - fëmijët ose prindërit/kujdestarët me aftësi të kufizuara ose sëmundje kronike, - fëmijë që punojnë, fëmijët në lëvizje, fëmijët që jetojnë në rrugë ose në institucionet e kujdesit rezidencial, fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit dhe fëmijët e privuar nga liria (p.sh. në paraburgim) <p>Me rëndësi! <i>Në situatën e pandemisë është domosdoshmëri hartimi i protokollit të qartë për Menaxhimin e Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, që është specifik për situatën Covid-19, si për modalitetet e identifikimit, ashtu dhe të trajtimit të rasteve të reja. Protokollin duhet të rishikohet dhe përditësohet rregullisht duke u adaptuar me udhëzimet dhe masat e marra për ruajtjen e sigurisë ndaj infektiveve.</i> <i>Në hartimin e këtij protokollin është e rëndësishme të merret parasysh se si do të ruhet konfidencialiteti i rastit nëse përdoren modalitetet e reja për identifikimin dhe Menaxhimin e Rastit.</i></p>
--	--

<p>3</p>	<p>Forcimi i mekanizmit të referimit për MF</p>
<p>Veprimet kryesore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimi i informacionit në nivel ndërsektorial mbi rrugët e reja të identifikimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbimet e tjera mbështetëse të disponueshme për fëmijët duke përfshirë personat e kontaktit në komunitet organizatat/agjencitë lokale.



	<ul style="list-style-type: none"> • Forcimi i lidhjes midis shërbimeve shëndetësore, arsomore dhe sociale në nivelin vendor dhe komunitar për të realizuar një reagim të procesit të Menaxhimit të Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ndaj rreziqeve dhe shqetësimeve që gjeneroi Covid-19, veçanërisht për identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes për fëmijët në rrezik. • Koordinimi ndërsektorial i shërbimeve për identifikimin dhe mbështetjen e familjeve ekonomikisht të rrezikuara, të prekura nga Covid-19. Kjo mund të përfshijë sigurimin e parave dhe ndihmave të tjera materiale përmes shërbimeve që mundëson procesi i Menaxhimit të Rastit, në fazën e tranzicionit derisa rastet të mund të mbulojnë nga sistemi i mbrojtjes sociale (NE, paga e luftës etj) • Bashkëpunim i ngushtë me grupet ekzistuese të mbrojtjes së fëmijëve me bazë komunitare dhe personat e kontaktit, të cilët tashmë kanë besimin e komunitetit për të identifikuar dhe referuar raste e fëmijëve në nevojë. • Qendrat rezidenciale, të trajtimit, njësitë e izolimit/ e karantinës mund të zhvillojnë procedura të brendshme dhe protokoll për referimin e sigurt të fëmijëve në nevojë për mbrojtje • Koordinim me strukturat përgjegjëse për identifikimin, referimin e fëmijëve refugjatë/azilkërkuar dhe përcaktimi i alternativa për përfshirjen e tyre në shërbimet e mbrojtjes sociale, pavarësisht statusit të tyre në vendin tonë. • Krijimi i një sistemi komunikimi emergjent mes strukturave dhe aktorëve (siç mund të jetë grupi në WhatsApp) dhe sigurohemi që të gjithë anëtarët të kuptojnë kanalet e komunikimit. • Përditësim i informacionit lidhur me numrin e punonjësve që janë aktivë në të gjitha strukturat përgjegjëse për identifikim dhe referim të rasteve. • Ndarja e eksperiencave dhe praktikave pozitive të funksionimit të mekanizmit referues për mbrojtjen e fëmijëve në situatën e pandemisë • Për një funksionim më të mirë të mekanizmit referues për mbrojtjen e fëmijëve në situatën e pandemisë duhet advokuar që: <p>procesi i Menaxhimit të Rastit të konsiderohet thelbësor pasi shërbimet e ofruara përmes kësaj metodologjie janë pjesë jetike e përgjigjes ndaj Covid-19. PMF-të si menaxher të rasteve dhe koordinues të procesit të MR duhet të mbështeten për të vazhduar ndjekjen e rasteve më të prekshme, me rrezik të lartë, pavarësisht nga Covid-19.</p> <ul style="list-style-type: none"> • PMF-të, punonjësit e shërbimit social dhe profesionistët që angazhohen në mbrojtjen e fëmijëve, të konsiderohen si
--	--



	<p>punonjës “të vijës së parë” për përballimin e situatës Covid-19.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të rritet numri i punonjësve socialë në spitale dhe qendra mjekësore, për të identifikuar, referuar pranë NJMF-ve/PMF-ve, fëmijët e ndarë nga prindërit/kujdestarët, fëmijët që kanë përjetuar abuzim ose neglizhencë apo pa kujdesin e duhur. • të fuqizohet shërbimi psiko-social në shkollë dhe funksionimi i grupit multidisiplinar, si një mënyrë për të përmirësuar bashkëveprimin brenda shkollës në identifikimin e hershëm dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë. • PMF-të dhe punonjësit socialë (nisur nga pozicioni) të shpërblehen nga ana monetare si punonjës të vijës së parë, të pajisen me mjetet e duhura higjieno-sanitare dhe të trajtohen mbi zbutjen e rrezikut gjatë pandemisë Covid-19 • Bashkëpunimi me OJF-të që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve, është jetik dhe vendimtar, por duhet të koordinohet dhe kanalizohet në mënyrën e duhur. • Me rëndësi në situatën e pandemisë është domosdoshmëri hartimi i një protokolli të qartë për Menaxhimin e Rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, që është specifik për situatën Covid-19, si për modalitetet e identifikimit, ashtu edhe të trajtimit të rasteve të reja. Protokolli duhet të rishikohet rregullisht duke u adaptuar me udhëzimet dhe masat e marra për ruajtjen e sigurisë ndaj infektiveve. • Në hartimin e këtij protokolli është e rëndësishme të merret parasysh koordinimi ndërsektorial dhe se si do të ruhet konfidencialiteti i rastit, nëse përdoren modalitetet e reja për identifikimin dhe menaxhimin e rastit.
--	---



4	Koordinimi/ bashkëpunimi ndërsektorial dhe komunitetin
Veprimet kryesore	<ul style="list-style-type: none"> • Përditësim i hartës së shërbimeve, duke evidentuar ato shërbime të mbrojtjes së fëmijëve për të cilat mund të ketë më shumë kërkesa gjatë Covid-19.(kujdesi shëndetësor, kujdesi alternativ, shërbime mbështetëse të bazuara në komunitet, ndihmë në para, shërbime bazike (që lidhen me të ushqyerit, higjienën, veshje), shërbimet ligjore etj. • Përditësimi i informacionit mbi shërbimet të cilat mund të mbyllen, zvogëlohen ose të ndryshohen për shkak të pandemisë. (shëndeti, arsimit, mbrojtja etj.). • Koordinim me aktorët e tjerë të menaxhimit të rasteve pjesë e GTN-së për të shpërndarë ngarkesën e rasteve të reja sipas vendndodhjes së rasteve dhe ekspertizës së aktorëve, duke përshtatur rrugët e referimit dhe burimeve. • Koordinim me autoritetet përgjegjëse lidhur me lëvizjet dhe udhëtimet e nevojshme të punonjësve për të siguruar që shërbimet të arrijnë te fëmijët më të rrezikuar nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi. • Shkëmbim informacioni i ndërsjelltë, në mënyrë të formalizuar me strukturat përgjegjëse për të kuptuar shtrirjen dhe shkallën e ndikimit të Covid-19. (informacion i përditësuar) • Koordinim me punonjësit e strukturave shëndetësore për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë, rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të infektuar apo rrezikuar nga Covid-19. • Vlerësim i rregullt, mbi mënyrat në të cilat pandemia dhe masat e reagimit ndaj saj, ndikojnë te fëmijët dhe realizimi i të drejtave të tyre.
Bashkëpunimi me komunitetin	<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe përditësimi i mënyrave të komunikimit me grupet ekzistuese të mbrojtjes së fëmijëve me bazë komunitare dhe personat e kontaktit në komunitet për të siguruar vazhdimësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit me qëllim identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për rastet e fëmijëve në nevojë. • Nëse identifikohen pika të reja fokale në komunitet për shkak të situatës aktuale Covid-19, sigurohemi që ata janë trajnuar mbi bazat e mbrojtjes së fëmijës të tilla si



	<p>identifikimin dhe referimin e sigurt si dhe parimet e punës për MF.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurohemi që grupet e komunitetit dhe pikat fokale të kenë informacion të saktë në lidhje me rreziqet që Covid-19 shkakton te fëmijët, vajzat dhe djemtë, përfshirë informacionet bazike, të tilla si: simptomat dhe mënyrat e transmetimit, në mënyrë që ata të mund të identifikojnë dhe referojnë në mënyrë të sigurt fëmijët dhe të luftojnë mitet që stigmatizojnë fëmijët e diagnostikuar me Covid-19 apo mitet e tjera që hasen në komunitet, të tilla si: Covid-19 nuk ekziston, nuk është i rrezikshëm, nuk na infektton ne etj. • Informacion i përditësuar (rrugët e referimit dhe hartëzimin e shërbimeve) me anëtarët e komunitetit, duke siguruar që rrugët e referimit të jenë lehtësisht të kuptueshme (p.sh., duke përdorur gjuhë të thjeshtë, të qarta apo të përkthyer sipas gjuhës përkatëse (p.sh. në gjuhën rome apo të pakicave etnike). • Sqaroni rolet e grupeve përkatëse të komunitetit dhe personave të kontaktit për të mbështetur fëmijët (ndërgjegjësim, ndjekja dhe mbështetja e rasteve, vizitat në shtëpi, etj.) • Sigurohemi që posterat për masat e mbrojtjes ndaj Covid-19 të jenë të vendosura në të gjithë zonën. • Sigurohemi që stafi / vullnetarët me bazë në komunitet kanë siguruar të gjitha mjetet e mbrojtjes të përshkruara në politika kombëtare shëndetësore (p.sh., maska, doreza, dezinfektantë etj.)
--	---

5	Adaptimi i shërbimeve dhe siguria e punonjësve të përfshirë në MR
Veprimet kryesore	<ul style="list-style-type: none"> • Adaptimi i shërbimeve në formën e “Shërbimeve në distancë” (aty ku është e mundur), duhet të jenë të synuara për një grup të veçantë të popullatës, si në rastin e linjave të ndihmës për fëmijët ose linjave të ndihmës për dhunën në familje, veçanërisht në situatë karantinimi gjatë emergjencës. • Marrja e masave për të siguruar akses të fëmijëve në shërbimet kryesore, ushqim, shëndetësi, mësim on-line, shërbime psiko-sociale, argëtuese, adresim të shqetësimeve, shërbime të mbrojtjes. • Marrja e masave paraprake për të parandaluar ndarjen fëmijë-familje dhe sigurimi i mbështetjes për fëmijët e lënë vetëm pa kujdes për shkak të shtrimit në spital ose vdekjes

	<p>së një prindi ose kujdestarit (shërbimi familje kujdestare, asistent social në familje etj)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje financiare për shërbimet e emergjencës, qendrat e përkohshme të kujdesit dhe familjet kujdestare, për të mbështetur emocionalisht fëmijët. • Ndihma në para. Nëse marketet dhe shërbimet janë ende funksionale, mbështetni disbursimin e shpejtë për familjet më të prekura përmes menaxhimit të rasteve. • Jepni përparësi prindërve/kujdestarëve të fëmijëve që kanë humbur mjetet e jetesës (p.sh. punën, vonesë në tërheqjen e pagës) për shkak të situatës Covid-19 duke mundësuar “ushqimet e shportës” që mbulojnë nevojat e familjes. • Punonjësit e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve u duhet të pajisen me burime dhe pajisje mbrojtëse personale (PMP) të mjaftueshme, në mënyrë që të ofrojnë shërbime mbrojtëse pavarësisht nga karantina dhe kufizimet e lëvizjes. • Angazhimi i punonjësve rezervë duhet të inkurajohet dhe lehtësohet për të ndihmuar punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe punonjësit socialë me përforsime shtesë, përndryshe sistemi aktual i mbrojtjes mund të rrezikojë të mos funksionojë kundrejt sfidave të mëdha. • PMF-të duhet të kenë akses në një fond specifik emergjence të menaxhimit të rasteve, veçanërisht nëse ata nuk mund të shkojnë në punë, por duhet ta ndjekin rastin në distancë. • Shëndeti, siguria, shëndeti mendor dhe mirëqenia psikosociale e ekipit të menaxhimit të rasteve të jetë prioritare • Të sigurohet supervizimi profesional për profesionistët për të qenë të motivuar dhe shmangur konsumimin profesional (burn-out) • Gjatë situatave të tilla si Covid-19 kujdesi për veten dhe kujdesi ndaj stafit të jetë prioritet dhe i vetë punonjësve që përfshihen në procesin e MR. • Informim i rregullt i azhornuar vetëm nga burime të verifikuara, ndarja e informacioneve të rëndësishme dhe kufizim në sasinë e informacionit të panevojshëm për të shmangur mbingarkesën e punonjësve. • Të krijohet një sistem komunikimi emergjent (siç mund të jetë grupi në WhatsApp) dhe sigurohuni që të gjithë anëtarët e ekipit të kuptojnë kanalet e komunikimit. • Të gjithë anëtarët e ekipit të kenë informacion të qartë kontakti se me kë të kontaktojnë në rast nevoje.
--	---



	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një klime miqësore mes anëtarëve të ekipit (përveç mbikëqyrjes së rregullt) për të inkurajuar mbështetjen e njëritjetrit dhe ngritjen e shqetësimeve. • Sigurimi i një sistemi të rrotacionit të stafit për të mundësuar që stafi të jetë në gjendje të pushojë dhe t'i kushtojë kohë familjes. • Sigurimi i burimeve për menaxhimin e stresit dhe ruajtjen e mirëqenies emocionale me stafin. Kjo mund të përfshijë ushtrime të thjeshta të vetë-kujdesit, materiale, ose numra telefoni për mbështetje psikologjike, etj.) • Përcaktojmë mënyrat më të mira për të mbajtur motivimin në distancë. • Trajnimi i profesionistëve të MR (përfshirë vullnetarët e komunitetit) mbi Covid-19, duke përfshirë simptomat, mënyrat e transmetimit dhe kontrolli i infeksionit në mënyrë që ata të mund të luftojnë mitet (si.psh.Covid-19 nuk ekziston, nuk është i rrezikshëm, etj) që mund të stigmatizojnë fëmijët dhe familjet e tyre. <p>Trajnimi i stafit të menaxhimit të rasteve mbi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - masat e mbrojtjes për të ruajtur sigurinë e tyre dhe se si të shpjegojnë masat për fëmijët dhe familjet e tyre. - si të përdoren (Pajisjet mbrojtëse personale) PMP-të, nëse janë të disponueshme për personelin e menaxhimit të rasteve - identifikimin e faktorët që rrezikojnë, mbrojtjen e fëmijës të cilat mund të lindin në kushtet e pandemisë, siç mund të jetë dhuna në familje, neglizhimi dhe neglizhenca specifikisht ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuar . - modalitetet alternative të menaxhimit të rasteve, dhe kur këto modalitete duhet të merren në konsideratë (p.sh. menaxhimi në distancë). - për realizimin e mbështetjes në distancë (p.sh. si të flisni me fëmijët me telefon, si të ruani konfidencialitetin/ mbrojtjen e të dhënave nga distanca, çështjet e mbrojtjes, si të kërkonti mbështetje nga mbikëqyrësi në rastet kritike, si të menaxhoni një grup në ehatsapp, linjë telefonike të ndihmës për fëmijë) - të punuarit on-line, organizimin e takimeve duke iu përshtatur kontekstit dhe duke siguruar konfidencialitetin gjatë izolimit për të gjithë anëtarët e GTN-së <ul style="list-style-type: none"> - Sigurim i logjistikës duke konsideruar pikat e mëposhtme (sipas kontekstit): <ul style="list-style-type: none"> - Pajisjet mbrojtëse personale (PMP) për vizitat në familje (rastet kur vizitat janë domosdoshmëri)
--	---



	<ul style="list-style-type: none"> - Pajisjet për këshillimin në distancë (telefona, karta telefoni, mjete të tjera) - Transport, nëse transporti publik nuk është më i disponueshëm ose jo i sigurt për t'u marrë.
--	---

6	Monitorimi, vlerësimi, kapitalizimi i modeleve pozitive të funksionimit të mekanizmit efektiv të mbrojtjes së fëmijëve në kushtet e pandemisë. Përfshirja e fëmijëve dhe familjeve në proces
Veprimet kryesore	<ul style="list-style-type: none"> • Për qëllime monitorimi, të realizohet analiza e të dhënave të MF dhe natyra e rreziqeve apo shqetësimeve të reja të krijuara gjatë pandemisë Covid-19 për të programuar dhe advokuar për ndryshimin e nevojave për mbrojtjen e fëmijëve si rezultat i krizës. • Sigurojmë të dokumentojmë dhe përpilojmë të gjitha përshtatjet dhe qasjet e zhvilluara të menaxhimit të rastit, si praktikat pozitive dhe të të padobishme ose të dëmshme për të nxjerrë mësim pas pandemisë dhe për t'i reflektuar në planet paraprake të emergjencës për të qenë të pregatitur më mirë nëse përsëriten situata krize të ngjashme. • Fëmijët të fuqizohen të marrin pjesë në mënyrë aktive për t'iu përgjigjur kësaj krize, përmes rrjeteve të bashkëmoshatarëve të tjerë në internet duke përdorur teknologjinë nën mentorimin e të rriturve (prindër, profesionistë). Në këtë mënyrë, ne do të sigurojmë që fëmijët të kontribuojnë vetë në adresimin e shqetësimeve të tyre gjatë kësaj pandemie.



Përgjegjësitë e institucioneve për adaptimin e 6 komponentëve kryesorë, për të siguruar një mekanizëm efektiv për mbrojtjen e fëmijës në kushtet e emergjencës, për shkak të pandemisë COVID-19

Institucionet/strukturat	Bashkitë rekomandohen të fokusohen në veprimet e mëposhtme për të siguruar një mekanizëm efektiv për mbrojtjen e fëmijës
Veprimet kryesore	<ul style="list-style-type: none"> • Të realizojnë vlerësimin e nevojave të fëmijëve dhe familjeve vulnerabël në territor për t'i adresuar në planin e mbrojtjes sociale dhe atë të emergjencës në veçanti. • Të hartojnë planin vendor të veprimit në kushtet e emergjencës si pjesë e planit social të mbrojtjes me aktivitete të kostuara. • Të ngrenë strukturat e NJVNR-së me burimeve njerëzore të duhura, përfshirë PMF-të parashikuar tashmë në ligjin Nr.121 për "Shërbimet shoqërore". • Të sigurojnë që PMF-të të ushtrojnë përgjegjësinë kryesore ligjore, adresimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje edhe në kushtet e emergjencës duke: shtuar numrin e PMF-ve sipas standardeve, rritur kapacitetet në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve mbi mbrojtjen e fëmijëve. • Të sigurojnë fond të posaçëm për MR në kushtet e emergjencës specifikisht për të garantuar ofrimin e shërbimeve sipas nevojave për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe familjet në kushtet e emergjencës. • Të sigurojnë infrastrukturën e posaçme për PMF-të për të punuar në distancë.
	Rekomandimet për sektorin e shëndetësisë



	<ul style="list-style-type: none"> • Të hartojë planin e emergjencës në të cilin të parashikohen masat e marra nga shëndetësia për të mbrojtur fëmijët gjatë pandemisë të Covid-19. • Të zhvillojë procedura të përbashkëta të koordinimit për identifikimin, dokumentimin dhe referimin e rasteve e fëmijëve në nevojë për mbrojtje midis shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve për të siguruar që fëmijët marrin shërbimet e duhura shëndetësore, përfshirë kujdesin e sigurt. • Të fuqizojë rolin e punonjësit social pranë strukturave shëndetësore si në spital, njësinë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), qendrave komunitare të shëndetit mendor (QKSHM), të cilët luajnë një rol të rëndësishëm koordinues me shërbimet e tjera të mbrojtjes së fëmijëve. • Të forcojë kapacitetet e stafeve mjekësore sidomos i linjës së parë mbi identifikimin e hershëm të rasteve të abuzimit të fëmijëve (veçanërisht abuzimi seksual) dhe sistemin e referimit. • Të parashikojë staf “rezervë” në strukturat shëndetësore duke e lehtësuar procesin nga procedurat burokratike apo veprimet e vonuara. • Të informojnë aktorët e mbrojtjes së fëmijëve kur ata kontaktojnë me një fëmijë, për të cilin ata dyshojnë se ka përjetuar dhunë, abuzim, neglizhencë, shfrytëzim dhe/ose ndarje nga familja ose humbje. • Të përditësojë informacione lidhur me numrin e punonjësve që janë aktivë për të dyja strukturat (NJMF/PMF dhe shëndetësi) për referime • Të koordinojë me sektorët e Shëndetësisë, Edukimit, Shërbimeve Sociale e Komunitare për të realizuar shpërndarjen e mesazheve kryesore të mbrojtjes së fëmijëve për fëmijët dhe prindërit/ kujdestarë. • Të kontribuojë në trajnimin e stafit të Shëndetësisë, Edukimit, Shërbimeve Sociale e Komunitare mbi rreziqet e mbrojtjes së fëmijëve të lidhura me Covid-19 dhe identifikimin dhe rrugët e referimit • Të trajnojë stafin për të ofruar këshillim dhe shërbime në distancë gjatë emergjencës për të mbështetur mirëqënien psiko-sociale të fëmijëve në faza të ndryshme të zhvillimit dhe nevojave.
	<p style="text-align: center;">Rekomandimet për sektorin e arsimit.</p>



	<ul style="list-style-type: none"> • Të forcojë shërbimin psiko-social në shkolla përmes shtimit të burimeve njerëzore. Të sigurojë që mësuesit, punonjësit e shërbimit psiko-social janë të trajnuar për çështje të mbrojtjes së fëmijëve dhe për të punuar në kushtet e emergjencës apo në ofrimin e shërbimit në distancë. • Të forcojë kapacitetet e mësuesve dhe shërbimit psiko-social mbi identifikimin e hershëm të rasteve të abuzimit të fëmijëve (veçanërisht abuzimi seksual) dhe sistemin e referimit. • Të sigurojë që të gjithë fëmijët të kenë akses në mësimin on-line. T'i kushtohet rëndësi mësimdhënies në distancë përmes radios, TV ose në internet (në varësi të kontekstit) dhe të mbështeten prindërit me paketa burimore për të asistuar fëmijët në procesin e të nxënës. • Të sigurohet që platformat e mësimdhënies online të jenë atraktive, miqësore dhe të nxisin të mësuarin interaktiv të fëmijëve dhe të përshtatura për një masë të gjerë të fëmijëve (jo vetëm për ata që fëmijë që kanë rezultate të mira) • Të parashikojë staf zëvendësues në shkolla për emergjencën dhe jo vetëm, duke e lehtësuar procesin nga procedurat burokratike apo veprimet e vonuara. • Të realizojë module me fëmijët mbi të mësuarit socio-emocional që të adresojnë stigmën dhe përjashtimin shoqëror shkaktuar nga pandemia Covid-19 dhe si të përdorin faktorët mbrojtës.



REFERENCA

Baza ligjore

- Ligji nr 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.”
- Udhëzimi nr 253, datë 10.04.2020 “Për menaxhimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid –19”.
- Ligji nr. 27/2019 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 44/2012 “Për shëndetin mendor”
- Ligji 121 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”
- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 157, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga Covid-19 të përfituesve të shërbimeve të perkujdesit shoqëror”
- Udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020 - 2021

Literatura

- Manuali për “Fuqizimin e familjes në kontekstin e pandemisë Covid-19” (Tahsini, Duci, Kreka)
- CP Alliance Technical Note Covid-19: protecting children from violence, abuse, neglect in the home
- Save the Children Child Protection: Covid-19 Guidance Children Deprived of their Liberty
- International Federation of Social Workers: Ethical Decision Making in Covid-19
- Save the Children psychological First Aid Training Manual for Child Practitioners: includes sessions 7 and 8 on communication ëith children and session 9 on communication ëith caregivers
- UNICEF MHPSS (April 2020): Covid-19 Operational Guidance for Implementation and Adaptation of MHPSS Activities
- R2HC Delivering Psychological Treatment to Children via Phone: guidance document sets out basic principles for the delivery of psychological therapy to children via telephone.



1.2 A jeni njohur me udhëzimin mbi menaxhimin e rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë pandemisë Covid 19?

Po ; Jo ; Pjesërisht

Nëse Po, a ju duket të dobishme për procesin e menaxhimit të rastit, gjatë periudhës së pandemisë Covid 19?

1.3 A ju duket e vështirë për veten dhe për stafin të zbatoni rregullat e sigurisë parashikuara në udhëzim për menaxhimin e rastit ?

Nëse po, pse?

2. Struktura

2.1 Sa persona janë punonjës për mbrojtjen e fëmijëve në zyrën tuaj? Si mund të siguroheni që gjithë zona që supozohet të mbuloni merr shërbimin?(te lutem shpjegohu)

2.2 A mendoni se ka staf mjaftueshëm? A keni kërkuar më shumë staf vecanërisht për të përballuar situatën e krijuar nga covid 19? (të lutem shpjegohu)

2.3 A mendoni se stafi për mbrojtjen e fëmijëve në bashkinë tuaj ka të gjitha aftësitë që kërkohen për të bërë punën në kushtet e emergjencës Covid 19?

2.4 A u ofrua ndonjë trajnim nga ministria e linjës apo agjensi të tjera në Bashki për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në situatën e emergjencës Covid 19?

Po ; Jo

Nëse Po, sa here, ku konsistoi dhe si u realizua?

2.5 A jeni ndjerë të mbështetur vlerësuar nga supervizori juaj gjatë punës tuaj dhe specifikisht gjatë pandemisë?

Po ; Jo

Nëse Po, si është kryer kjo procedurë?

2.6 Si mendoni se situata e emergjencës Covid 19 ka ndikuar tek procesi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ?

2.7 A keni pasur pajisjet e duhura personale të higjienës për mbrojtjen ndaj Covid 19 parashikuar në protokollin e sigurisë?

Po

Jo

Tjetër

3. Menaxhimi rastit



3.1 A mund të na përshkruani cilat janë mënyrat e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së pandemisë Covid 19(përfshirë periudhën e izolimit)?

3.2 Ju lutem jepni të dhënat për nr. e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje për periudhat e paraqitura në tabelë?

Janar –Qershor 2019	Janar –Qershor 2020	Janar –Qershor 2021

3.3A keni identifikuar raste të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm gjatë periudhës së pandemisë Covid 19(përfshirë periudhën e izolimit)?

3.4Si keni vepruar për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes bazuar dhe në respektimin e protokollit të sigurisë? Cilat kanë qenë/janë sfidat në ekzekutimin e këtyre masave?

3.5A janë mbledhur GTN-të për menaxhimin e rasteve të identifikuara gjatë periudhës së pandemisë Covid 19(perfshirë periudhën e izolimit)?Si keni proceduar?Cilat kanë qenë sfidat?

3.6 A i referoni rastet tek shërbime të tjera?

Po ; Jo .

Nëse Po,si është kryer kjo procedurë? Cilat janë sfidat kryesore që ndeshni?

4.Shërbimet

4.1. Me çfarë veshitirësish janë ndeshur e po ndeshen, fëmijët dhe familjet në nevojë përgjatë pandemisë COVID 19?

1. Nuk e di .
2. Vështirësi ekonomike .
3. Vëshirësi në respektimin e masave mbrojtëse .
4. Mungesë aksesi në mësimin online/apo në klasë të fëmijës?
5. Papunësi .
6. Frikë/ankth/stres nga sëmundja .
7. Rritje të agresivitetit/dhunës brenda familjes .
8. Përkeqsim në shëndet/sëmundjet kronike .
9. Përkeqsim në shëndetin mendor .
10. Mungesë informacioni se si të veprojnë, apo ku të drejtohen .
11. Mungesë informacioni mbi shërbimet që mund t'i ndihmojnë .

12. Tjetër ; specifikoje _____

4.2Cilat janë shërbimet që ofroi/ofron zyra juaj për të mbrojtur fëmijët gjatë emergjencës?



4.3A keni hartuar një plan veprimi si NJMF/Bashki për gatishmërinë në raste emergjencash?

Po ; Jo .

4.4. Nëse po, cfarë masash janë parashikuar në këtë plan ? Si është kryer kjo procedurë? Cilat janë sfidat kryesore që ndeshni?

4.5 A i keni përfshirë fëmijët dhe familjet e tyre tek planifikimi dhe ofrimi shërbimit?

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1 Si është realizuar monitorimi i rasteve gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 (përfshirë periudhën e izolimit)? Si keni proceduar?

- a) vizita në familje?
- b) në distancë/komunikim online?
- c) tjetër?

5.2 Si keni vepruar kur keni konstatuar që fëmija apo anëtari i familjes është i infektuar me Covid 19?

5.3A keni pasur mundësi të keni kontakte me të gjitha rastet në proces monitorimi gjatë periudhës së pandemisë Covid 19 (përfshirë periudhën e izolimit)? Cfarë sfidash keni hasur, veçanërisht për pjesën e logjistikës? Si keni gjetur zgjidhjen?

6. Koordinimi

6.1 Si e keni /dhe vazhdoni ta koordinoni punën tuaj me ofruesit e tjerë të shërbimeve në nivel bashkie gjatë periudhës së pandemisë Covid 19 (përfshirë periudhën e izolimit)?

6.2A ka funksionuar/funksionon ky bashkëpunim? A mund të jepni disa shembuj? Cilat janë sfidat?

6.3 Si mund të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi në nivel bashkie?

7. Buxheti

7.1 A u planifikua buxhet nga bashkia për Menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në periudhën e pandemisë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër

7.2 Nëse Po, a është i mjaftueshëm buxheti i caktuar? Mund të shpjegoni pse?



8.Sugjerime

Nisur nga përvoja juaj dhe sfidat e hasura për menaxhimin e rasteve gjatë pandemisë Covid-19, çfare do të sugjeroni që duhet të bëjë bashkia? po strukturat e tjera përgjegjëse si policia,arsimi,shëndetsia,OJf-të për të qenë më të përgatitur për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve në situata Emergjente?

Faleminderit!

Aneksi 2. Intervistë për punonjësit e Shëndetsisë, QKM, OJF

Përshëndetje, quhem _____ dhe aktualisht jam e ngarkuar në realizimin e Vlerësimit të procesit të menaxhimit të rastit dhe mekanizmave lokalë të referimit me një fokus të veçantë në Shëndetin dhe Mbrojtjen, projekt i implementuar nga Terre des hommes – Misioni në Shqipëri e cila, është organizatë jo-fitim prurëse që operon në Shqipëri që prej vitit 1993 në kuadër të fuqizimit të sistemit dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve nga keqtrajtimi, shfrytëzimi, braktisja dhe trafikimi

Vlersimi do të ofrojë rekomandime në drejtim të ndërhyrjeve për të përballuar sfidat që situatat e Emergjencës si COVID 19, shkaktojnë në mirëqenien e fëmijëve si edhe ofrimin e ideve/sugjerimeve/aftesive për adresimin e tyre.

Informacioni i marre prej jush konsiderohet i rëndësishem në përgatitjen e rekomandimeve dhe të materialeve informuese.

SEKSIONI 1 Informacion mbi te intervistuarin

8. Emri i të intervistuarës/rit	
9. Gjinia	Femër <input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/>
10. A jeni :	Pjesë e stafit të Bashkisë <input type="checkbox"/> Pjesë e stafit të OJF <input type="checkbox"/> Pjesë e stafit të QKM <input type="checkbox"/> Staf i Qendrës Shëndetësore <input type="checkbox"/>
11. Ne cilën bashki punoni?	Tiranë <input type="checkbox"/> Shkodër <input type="checkbox"/> Durrës <input type="checkbox"/> Fier <input type="checkbox"/> Lezhë <input type="checkbox"/> Korçë <input type="checkbox"/>
12. Puna juaj mbulon:	Zonë urbane <input type="checkbox"/> Zonë rurale <input type="checkbox"/>
13. Detyra brenda bashkisë, OJF/Qendër Komunitare Multifunkionale(QKM)/Qendër Shëndetsore	
14. Data e intervistimit	____/____/2021



1.Me cilat kategori te mëposhtme lidhet aktiviteti i punës tuaj?

1. Fëmijë në nevojë për mbrojtje.(fëmijë të abuzuar, neglizhuar,shfrytëzuar)etj
2. Familje të varfra
3. Familje të varfra me fëmijë të drejtuar nga gra
4. Femije/adoleshente ne nevoje
5. Tjeter, specifikoje

2A mund të na përshkruani cilat janë mënyrat e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së pandemisë Covid 19(perfshirë periudhën e izolimit)?

3 Ju lutem jepni të dhënat për numrin e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje për periudhat e paraqitura në tabelë?

Janar - Qershor 2019	Janar -Qershor 2020	Janar –Qershor 2021

4. A keni qenë pjesë e Grupit teknik ndërsektorial(GTN) për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje koordinuar nga PMF?

5.Cfarë shërbimesh ofron Sektori/Qendra shëndetsore/QKM/ apo OJF-ja ku punoni, për fëmijët në nevojë?

1. Menaxhim multidisiplinar i rastit
2. Shërbime rehabilituese
3. Ndhmë psiko-sociale
4. Ndhme mjeksore
5. Informacion
6. Shërbime referimi
7. Këshillim online
8. Reintegrimit në tregun e punës
9. Shërbime për fuqizimin e familjes
10. Tjetër , specifikoje _____

6. Me cilët aktorë lokalë por jo vetëm keni bashkëpunuar në ofrimin e këtyre shërbimeve?

- a) Punonjës in e mbrojtjes së fëmijëve në Bashki/NJA?
- b) Policinë ?
- c) Shërbimet shëndetsore?



d) Shoqatat,OJF-të ?

e) Shërbimin psiko-social,/mësuesin në shkollë ?

ë) Tjetër?

7.Me çfarë vështirësish janë ndeshur e po ndeshen, fëmijët dhe familjet në nevojë (të artikuluar prej jush), përgjatë pandemisë COVID 19?

1. Nuk e di
2. Vështirësi ekonomike
3. Mungesë aksesit në mësimin online
4. Vëshirësi në respektimin e masave mbrojtëse
5. Mungesë shërbimi shëndetsor
6. Papunësi
7. Frikë/ankth/stres nga sëmundja
8. Rritje të agresivitetit/dhunës brenda familjes
9. Përkeqsim në shendet/semundjet kronike
- 10.Përkeqsim të shendetit mendor
- 11.Mungesë informacioni se si të veprojnë, apo ku të drejtohen
- 12.Mungesë informacioni mbi shërbimet që mund t'i ndihmojnë
- 13.Tjetër ; specifikoje _____

8.A keni një plan veprimi në kushtet e emergjencës në ofrimin e këtyre shërbimeve?

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër

Nëse po çfarë masash janë parashikuar?

9.Nisur nga përvoja juaj dhe sfidat e hasura për menaxhimin e rasteve gjatë pandemisë Covid-19 çfarë do të sugjeroni që duhet të bëjë bashkia? po strukturat e tjera përgjegjëse si policia,arsimi,shëndetsia,OjF-të për të qenë më të përgatitur për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve në situata Emergjente ?

Faleminderit !



Aneksi 3. Intervitë për punonjësit e shërbimit psiko-social/ drejtues/ mësues të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme

Përshëndetje, quhem _____ dhe aktualisht jam e ngarkuar në realizimin e Vlerësimit të procesit të menaxhimit të rastit dhe mekanizmave lokalë të referimit me një fokus të veçantë në Shëndetin dhe Mbrojtjen, projekt i implementuar nga Terre des hommes – Misioni në Shqipëri e cila, është organizatë jo-fitim prurëse që operon në Shqipëri që prej vitit 1993 në kuadër të fuqizimit të sistemit dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve nga keqtrajtimi, shfrytëzimi, braktisja dhe trafikimi

Vlersimi do të ofrojë rekomandime në drejtim të ndërhyrjeve për të përballuar sfidat që situatat e Emergjencës si COVID 19, shkaktojnë në mirëqenien e fëmijëve si edhe ofrimin e ideve/sugjerimeve/aftesive për adresimin e tyre. Informacioni i marre prej jush konsiderohet i rëndësishëm në përgatitjen e rekomandimeve dhe të materialeve informuese.

Emri i Shkollës: _____

Njësia Administrative: _____

Bashkia _____

1. Gjatë periudhës së pandemisë (vecanërisht gjatë kohës së karantinës) a identifikuat fëmijë në nevojë për mbrojtje (fëmijë të abuzuar, shfrytëzuar, neglizhuar) etj.

- a) Po
- b) Jo
- c) Tjetër

Nëse po, si vepruat? (ju lutem shpjego)

2. Ju lutem jepni të dhënat për numrin e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (fëmijë të abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar etj) për periudhat e paraqitura në tabelë?

Janar – Qershor 2019	Janar – Qershor 2020	Janar – Qershor 2021



3.A keni qenë pjesë e Grupit teknik ndërsektorial(GTN) për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje koordinuar nga PMF(punonjësi për mbrojtjen e fëmijës)?

- a) Po
- b) JO

c) Nëse po, si u mblodh grupi(online, fizikisht)?

4.A paten/kanë të gjithë nxënësit akses për të ndjekur mësimin online?

Po

Jo

Një pjesë

Nëse jo /një pjesë, çfarë masash janë marrë për tu dhënë mundësinë e ndjekjes së mësimin online fëmijëve në nevojë?

- a) U shpërndanë tableta
- b) U koordinua me NJMF në Bashki për rastet e fëmijëve me probleme socio-ekonomike
- c) U siguroa internet për fëmijët në vështirësi ekonomike
- d) Tjetër

5.Keni identifikuar raste të fëmijëve/familjeve që kërkuar ndihmë për mbështetje ekonomike gjatë pandemisë?

Po

Jo

Tjetër

Nëse po, si vepruat?

6.Cilat janë masat kryesore shëndetësore që janë zbatuar në shkollë?

4.Cfarë ndodh nëse fëmija shfaq një ose disa simptoma të Covid-19?

6.A informoheni nga strukturat shëndetsore për fëmijët dhe prindërit e tyre të cilët rezultojnë pozitivë në shkollën tuaj?

7. A jeni të azhurnuar me udhëzimet dhe protokollet për mbrojtjen ndaj Covid 19?

8 Si i ka mbështetur shkolla nxënësit që nuk mundën/mund të ndjekin mësimin online apo në klasë? Të lutem shpjego masat e marra.

9.Me cilët aktorë keni bashkepunuar në nivel lokal për të siguruar akses në shërbime për fëmijët në nevojë për mbrojtje (fëmijë të abuzuar, shfrytëzuar, neglizhuar, keqtrajtuar)?

A Punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve në Bashki?

B Policinë?

C Shërbimet shëndetsore?



D Shoqatat, OJF-të?
E Tjetër.

10. Nisur nga përvoja juaj dhe sfidat e hasura për menaxhimin e rasteve gjatë pandemisë Covid-19 çfare do të sugjeroni që duhet të bëjë bashkia? po strukturat e tjera përgjegjëse si policia, arsimit, shëndetsia, OjF-të për të qenë më të përgatitur për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve në situata Emergjente?

Faleminderit !

Aneksi 4. Fokus Grupe me Fëmijët dhe Prindërit

Pjesëmarrja në Fokus Grupe

Përzgjedhja e pjesëmarrësve të fokus grupeve me fëmijët dhe prindërit do të mbështetet në termat e referencës së vlerësimit që lidhet me fëmijë dhe prindër në nevojë dhe që kanë marrë shërbime gjatë periudhës së Pandemisë Covid 19. Thirrjen / ftesën për takim / fokus grup do ta zhvillojë ose punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve / Bashki ose Punonjësi social i qendrave komunitare. Në fokus grupe do të ftohen të marrin pjesë afërsisht 15 fëmijë në nevojë për mbrojtje që marrin shërbime pranë qendrave komunitare. Rrjedhimisht, në *Fokus Group 1/ fëmijët*, do të marrin pjesë afërsisht 15 fëmijë të moshës 10- 18 vjeç. Për secilin fëmijë pjesëmarrës në *Fokus Group 1/per fëmijët*, do të ftohet të marrë pjesë në *Fokus 2/ për Prindërit* edhe prindi apo kujdestari i tij / saj, rrjedhimisht edhe ky Grup i prindërve do të ketë afërsisht 15 persona.

Vendi i përshtatshëm për Fokus Grupet me fëmijët dhe prindërit

Takimet/ fokus grupet është mirë të zhvillohen në një qendër komunitare.

Struktura e Fokus Grupeve

Fokus Grupet do të synohet të zhvillohen paralelisht në të njëjtën kohë. Përpara zhvillimit të tyre, fëmijëve dhe prindërve do tu shpjegohet qëllimi i takimit / fokus grupit, përmbajtja e pyetjeve dhe organizimi i tyre. Qëllimi i kësaj séance të përbashkët është që të merret leja e informuar gojarisht e prindërve dhe kujdestarëve për zhvillimin e takimit. dhe nuk do të zgjasin më shumë se 95 minuta – prindërit do të kenë një takim 10 minuta më të shkurtër se fëmijët në mënyrë që të kenë mundësi të presin fëmijët e tyre.



Strukturimi i takimeve do të jetë sipas pjesëmarrjes- metoda për fëmijët metoda për të rriturit, megjithatë linjat e përmbajtjes do të jenë të njëjta., do të përqëndrohen kryesisht tek informimi për mbrojtjen e fëmijeve dhe menaxhimi i rastit,situata e emergjencës(Covid 19), ofrimi i shërbimeve gjatë emergjencës, të zhvilluara deri në momentin e takimit dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

Përmbajtja

Pjesa e përbashkët : Falenderime për pjesëmarrjen, shpjegimi i qëllimit të takimeve, orientimi ku do të qëndrojnë / zhvillojnë takimin dy grupet	
Fokus Group me fëmijët	Fokus Group me Prindërit
II (10 minuta) Lojë hapjeje –	II (10 minuta) Lojë hapje – loja e lëmshit që formon një rrjetë . Drejtuesi i takimit / lehtësuesi thotë emrin e vet dhe moshën dhe emrin e një fëmije / fëmijëve të cilët i ka të dashur dhe për të cilët shqetësohet (mund të thotë ose jo shqetësimin që ka) – ideja është që ne jemi një rrjet që na bashkon shqetësimi për fëmijët.
III (15 minuta) Shpjegimi se çfarë është Situata e emergjencës, Fëmije në nevojë për mbrojtje, Menaxhimi i rastit dhe ofrimi i shërbimeve në kushtet e emergjencës.	III (15 minuta) Shpjegimi se çfarë është Situata e emergjencës, Femijë në nevojë për mbrojtje, Menaxhimi i rastit dhe ofrimi i shërbimeve në kushtet e emergjencës.
IV(20 minuta).Me çfarë vështirësish jeni ndeshur e po ndesheni, përgjatë pandemisë COVID 19? 1. Nuk e di <input type="checkbox"/> ; 2. mungesë ushqimi/ veshtirësi ekonomike <input type="checkbox"/> ; 3. pamundësi për femijët për të ndjekur shkollën online/apo në klasë? Arsyet? 4.Vështirësi në respektimin e masave mbrojtëse <input type="checkbox"/> ;	IV.(20 minuta)Me çfarë vështiresish jeni ndeshur e po ndesheni, pergjatë pandemisë COVID 19? 1. Nuk e di <input type="checkbox"/> ; 2. mungesë ushqimi/vë shtirësi ekonomike <input type="checkbox"/> ; 3. pamundësi për femijët për të ndjekur shkollën online/apo në klasë? Arsyet? 4. Vështirësi në respektimin e masave mbrojtëse <input type="checkbox"/> ;



<p>5. Prindërit e Papune <input type="checkbox"/>;</p> <p>6. Frikë/ankth/stres nga sëmundja <input type="checkbox"/>;</p> <p>7. Rritje te agresivitetit/dhunës brenda familjes <input type="checkbox"/>;Arsyet?</p> <p>8.Infektim me covid/ <input type="checkbox"/> humbje jete<input type="checkbox"/>?</p> <p>9. Përkeqsim në shëndet/sëmundjet kronike <input type="checkbox"/>;</p> <p>10. Përkeqsim të shëndetit mendor <input type="checkbox"/>;</p> <p>11. Mungesë informacioni se si të veprojnë, apo ku të drejtohen <input type="checkbox"/>;</p> <p>12. Mungesë informacioni mbi shërbimet që mund t'i ndihmojnë <input type="checkbox"/>;</p> <p>13. Tjetër <input type="checkbox"/>; specifikoje</p> <hr/> <p>14. Cfarë shërbimesh morët lidhur me nevojat e mësipërme?</p>	<p>5. Papunësi <input type="checkbox"/>;</p> <p>6.Frikë/ankth/stres nga sëmundja <input type="checkbox"/>;</p> <p>7. Rritje të agresivitetit/dhunës brenda familjes <input type="checkbox"/>;Arsyet?</p> <p>8.Infektim me covid/ <input type="checkbox"/>/humbje jete<input type="checkbox"/> ?</p> <p>9. Përkeqsim në shëndet/sëmundjet kronike <input type="checkbox"/>;</p> <p>10.Përkeqsim të shendetit mendor <input type="checkbox"/>;</p> <p>11.Mungesë informacioni se si të veprojnë, apo ku të drejtohen <input type="checkbox"/>;</p> <p>12. Mungesë informacioni mbi shërbimet që mund t'i ndihmojnë <input type="checkbox"/>;</p> <p>13. Tjetër <input type="checkbox"/>; specifikoje</p> <hr/> <p>14. Cfarë shërbimesh morët lidhur me nevojat e mësipërme?</p>																
<p>V (20 minuta)Çfarë kanë bërë të rriturit (strukturat shtetërore si Bashkia ,Arsimi, Shëndetsia, Organizatat etj)që të mos rritet rreziku i abuzimit të fëmijëve gjatë emergjencës dhe që femijët të mbështeten me shërbimet e nevojshme?</p> <p>Përgjigjet do të futen në një tabelë</p> <table border="1" data-bbox="256 1703 797 1885"> <thead> <tr> <th>Të rriturit</th> <th>Çfarë kanë bërë ?</th> <th>Si e kanë bërë ?</th> <th>Pse mirë ose</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Të rriturit	Çfarë kanë bërë ?	Si e kanë bërë ?	Pse mirë ose					<p>V (20 minuta)Çfarë kanë bërë strukturat shtetërore si Bashkia ,Arsimi, Shëndetsia, Organizatat etj)që të mos rritet rreziku i abuzimit të fëmijëve gjatë emergjencës dhe që femijët të mbështeten me shërbimet e nevojshme?</p> <p>Përgjigjet do të futen në një tabelë</p> <table border="1" data-bbox="816 1686 1365 1885"> <thead> <tr> <th>Të rriturit</th> <th>Çfarë kanë bërë ?</th> <th>Si e kanë bërë ? (mir</th> <th>Pse mirë ose</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Të rriturit	Çfarë kanë bërë ?	Si e kanë bërë ? (mir	Pse mirë ose				
Të rriturit	Çfarë kanë bërë ?	Si e kanë bërë ?	Pse mirë ose														
Të rriturit	Çfarë kanë bërë ?	Si e kanë bërë ? (mir	Pse mirë ose														



		(mir ë, keq)	keq ?			ë, keq)	keq ?												
Të rritur Prindër				Të rritur Prindër															
Shteti Bashkia/NJMF Shkollat Qendrat shëndetsore				Shteti Bashkia/NJMF Shkollat Qendrat shëndetsore															
Të rritur mësues/shërbi mi psiko-social ne shkollë				Të rritur mësues/shërbi mi psiko-social në shkollë															
Të rritur të tjerë lagja / komunitetit				Të rritur të tjerë (lagja, komuniteti)															
Organizatrat				Organizatrat															
Te tjere				Te tjere															
<p>V (20 minuta) Çfarë duhet të bëjnë të rriturit sot e tutje që fëmijët të kene sherbimet e duhura edhe ne situatë Emergjence. ?</p> <p>Përgjigjet do futen në një tabelë</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kush duhet ta bëjë ?</th> <th>Çfarë duhet të bëjnë ?</th> <th>Kush t'i kontrolloj ë si do ta bëjnë ?</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				Kush duhet ta bëjë ?	Çfarë duhet të bëjnë ?	Kush t'i kontrolloj ë si do ta bëjnë ?				<p>V (20 minuta)Çfarë duhet të bëjnë strukturat pergjegjese shteti,agjensite e tjera sot e tutje që fëmijët te kene sherbimet e duhura edhe ne situatë Emergjence. ?</p> <p>Përgjigjet do futen në një tabelë</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kush duhet ta bëjë ?</th> <th>Çfarë duhet të bëjnë ?</th> <th>Kush t'i kontrollojë si do ta bëjnë ?</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>				Kush duhet ta bëjë ?	Çfarë duhet të bëjnë ?	Kush t'i kontrollojë si do ta bëjnë ?			
Kush duhet ta bëjë ?	Çfarë duhet të bëjnë ?	Kush t'i kontrolloj ë si do ta bëjnë ?																	
Kush duhet ta bëjë ?	Çfarë duhet të bëjnë ?	Kush t'i kontrollojë si do ta bëjnë ?																	

Të rriturit Prindër			Të rriturit Prindër		
Të rriturit mësues			Të rriturit mësues		
Të rriturit punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve			Të rriturit punonjësit e mbrojtjes së fëmijës		
Të rriturit/Punonjësit e shëndetsisë			Territurit/Punonjësit e shëndetsisë		
Të rriturit e tjerë të lagjes / qytetit			Të rriturit e tjerë të lagjes / qytetit		
Organizatrat			Organizatrat		
Te tjerë			Te tjerë		
Shërbimet kryesore që mund tu referohen (jepen si ndihme për ti orientuar)			Shërbimet kryesore që mund tu referohen (jepen si ndihmë për ti orientuar)		
Që të regjistrohen			Që të regjistrohen		
Që të kenë ushqim dhe veshje			Që të kenë ushqim dhe veshje		
Që femijet të jenë të sigurt			Që femijet të jenë të sigurt		
Që të mjekohen			Që të mjekohen		
Te trajtohen për probleme të shëndetit mendor/edhe në kushte izolimi prej pandemisë			Të trajtohen për probleme të shëndetit mendor/edhe në kushte izolimi prej pandemisë		
Që të vaksinohen			Që të vaksinohen		
Që të shkojnë në shkollë rregullisht/ të			Që të shkojnë në shkollë rregullisht/ të		

kenë mundësi të ndjekin mësimin online		kenë mundësi të ndjekin mësimin online	
Që të kenë një strehe		Të kenë mundësi për këshillim psikologjik	
Të kenë mundësi për këshillim psikologjik		Që të kenë një strehe	
Që të jetojnë me prindërit e tyre(kujdestarët)		Që të jetojnë me prindërit e tyre(kujdestarët)	
Që të argëtohen		Që të argëtohen	
Që femijet të kenë mundësi të referojnë shqetësimet e tyre/edhe në kushtet e izolimit		Që femijet kanë mundësi të referojnë shqetësimet e tyre/edhe në kushtet e izolimit	
Që të parandalohet abuzimi i fëmijëve në kushtet e emergjencës.		Që të parandalohet abuzimi i fëmijëve në kushtet e emergjencës.	
VI Loja e mbylljes dhe mbyllja (10 minuta)			
Total 95 minuta		Total 85 minuta	

